



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 585/ Prot.
11

Tiranë, më 06/03 /2023

VENDIM

Nr. 04, datë 06.03.2023

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTEVE TË PUNËS MËSIMORE DHE
KËRKIMORE-SHKENCORE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR
VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e UPT-së, Planin Strategjik 2019-2024 të UPT-së, Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, Udhëzimi Nr. 24, datë 21.10.2019, Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.03.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportet e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2021-2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maligari



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nr. 585/ Prot.
3

Tiranë, më 06/03 /2023

Miratoi:

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Andrea Maliqari



ANALIZA VJETORE E PROCESIT MËSIMOR
TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK
TË TIRANËS

VITI AKADEMIK

2021-2022

Përgatitur:

Drejtoria e Kurrikulave

Prof. Asoc. Mimoza Cukalla

Kontrolloi:

Z/Rektori për anën Mësimore

Prof. Dr. Akli Fundo



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Raportimi i Analizës së Punës mësimore në UPT

Viti akademik 2021-2022

Hyrje

Analiza e punës mësimore në UPT është një proces që zhvillohet cdo vit akademik dhe përfshin të gjitha aspektet e procesit mësimor. Kjo analizë mbështetet kryesisht në analizën e bërë në departamentet dhe fakultetet e UPT, si dhe në të dhënat statistikore që mbahen në rektorat. Kjo analizë përmbledhet nga Drejtoria e Kurrikulave dhe është objekt diskutimi në mbledhje të posaçme të Senatit Akademik.

Procedura për kryerjen e kësaj analize fillon me departamentin, ku secili prej pedagogëve ka raportuar për aktivitetin e tij mësimor, duke plotësuar formularin “Raportimi i Pedagogut për Aktivitetin mësimor”. Në këtë raportim, pedagogu shpreh gjykimin e tij në lidhje me cilësinë e realizimit të programit të lëndës dhe problematikat që kanë dalë. Departamentet bëjnë analizën në lidhje me programet e studimit që kanë nën përgjegjësi, të cilën e raportojnë në formularin “Raportimi i analizës së punës mësimore të departamentit”. Përmbledhjet e analizës së departamenteve si dhe të dhënat statistikore në nivel fakulteti janë objekt diskutimi dhe debati në dekanatet e fakulteteve dhe në asamblenë e personelit akademik të njësisë kryesore. Të gjitha raportet e diskutuara dhe miratuara në nivel njësie kryesore përcillen në rektorat dhe shërbejnë si bazë për të bërë analizën e përgjithshme në nivel institucional. Në këtë analizë, Drejtoria e Kurrikulave mbështetet në të dhënat e shumta statistikore, raportimet e fakulteteve, si dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë implementimit dhe monitorimit të proceseve që lidhen me zhvillimin kurrikular dhe mësimdhënien në UPT.

I. Informacion mbi Procesin mësimor

A. Të dhëna mbi programet e studimit

Universiteti Politeknik i Tiranës ofron programe studimi në fushat inxhinierike, në të tre ciklet e studimit, referuar nivelit të 6_të, 7_të, 8_të të kualifikimit në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimit. Programet e studimit në UPT ofrohen në përputhje të plotë me misionin e UPT, në fushat inxhinierike të gjeologjisë, burimeve minerare, naftës&gazit, mekanike, materiale, tekstil dhe konfeksione, energjitikë, automatizim industrie, mekatronike, elektronike, telekomunikacion, inxhinieri informatike, inxhinieri matematike, inxhinieri fizike, ndërtim, mjedis, hidroteknikë, gjeodezi dhe në ato të arkitekturës, urbanistikës, interier dizajn dhe restaurim monumentesh kulture. Programet e studimit që ofrohen nga departamentet në fakultetet e UPT jepen në Shtojcë (Tabela 1. Lista e programeve të studimit me kohë të plotë të miratuara). Ato janë në përputhje me profilin e departamenteve dhe të fakulteteve që i ofrojnë. Programet e studimit të çdo fakulteti kanë lidhje organike me njera tjetrën dhe një bërthamë të përbashkët të disiplinave bazë formuese. Organizimi i Programeve të Studimit bëhet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Të gjitha programet e studimit



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

të ciklit të parë dhe të dytë ofrohen me kohë të plotë. Programet e studimit të formimit të vazhduar dhe ato të doktoraturës janë ofruar me kohë të zgjatur. Në total, në UPT ofrohen programet e studimit (pa llogaritur profilet) si me poshtë:

UPT	Nr.pr.stud . bachelor	Nr.pr.st.Maste r i Shkencave	Nr.pr.st.integrua r Master i Shkencave	Nr.Pr.st. Master Profesional	Nr.programeve formimit të vazhduar
Të licensuar	21	20	1	18	3
Aktive 21-22	21	17	1	14	3

Organizimi i Programeve të Studimit, sipas cikleve të studimit dhe profilizimeve të tyre jepen si më poshtë:

Cikli i Parë i Studimeve

Në Ciklin e Parë të Studimeve ofrohen gjithsej 22 Programe Studimi sëbashku me profile, të licencuara, të gjitha aktive në Vitin Akademik 2021-2022. Programet e studimit të Ciklit të Parë ofrohen me 180 ECTS në sistemin e studimeve me kohë të plotë.

Cikli i Dytë i Studimeve

Në ciklin e dytë të studimeve ofrohen lloje të ndryshme Programesh Studimi, si:

- Programe studimi “Master i Shkencave”, të cilat janë të organizuara me 120 ECTS, në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike. UPT ofron 20 programe studimi Master i Shkencave, përgjithsisht të organizuara me profile. Në vitin akademik 2021-2022, në total, kanë qenë aktive 23 profile të programeve të studimit “Master i Shkencave”.
- Programe studimi të integruar “Master i shkencave”, të organizuara me 300 ECTS në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e tyre është 5 vite akademike. Në UPT ofrohet gjithsej një program i integruar me 2 profile në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës, të dyja aktive në vitin akademik 2021-2022.
- Programe studimi “Master Profesional”, të cilat ofrohen me 60 ECTS dhe 120 ECTS në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e tyre është përkatësisht një vit akademik dhe dy vite akademike. Në përfundim të studimeve, studenti fiton Diplomën “Master Profesional” në fushën përkatëse inxhinierike.. Në vitin akademik 2021-2022, kanë qenë aktive 6 programe të studimit me 120 ECTS dhe 8 programe studimi me 60 ECTS.

Të gjitha programet e studimit, që ofrohen në UPT, janë nën përgjegjësinë e njësisë bazë përkatëse, me përjashtim të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, që mbështetet nga 3 njësi bazë të fakultetit, fusha akademike dhe kërkimore e të cilave është brenda Inxhinierisë Mekanike.

UPT rishikon periodikisht planet mësimore dhe ndërmerr proceset për përmirësimin e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Programet e studimit të formimit të vazhduar

Universiteti Politeknik i Tiranës ofron 3 programe studimi të formimit të vazhduar të licencuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, si më poshtë vijon:

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në bashkëpunim me Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, ofron programin e studimit të formimit të vazhduar në “Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme”.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Energjitikës, ofron programin e studimit të formimit të vazhduar për “Auditim Energjie”, i cili mbështetur në kërkesat dhe nevojat e tregut është riorganizuar në dy profile: “Procese” dhe “Ndërtesa”.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Prodhim-Menaxhimit në bashkëpunim me departamentin e Mekanikës, në zbatim të kornizës ligjore për vlerësimin e linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve, ofron kursin e formimit të vazhduar në “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”.

Programet e studimit të formimit të vazhduar synojnë të ofrojnë plotësime, thellim dhe freskim të njohurive, si dhe të shërbejnë për t’i dhënë kandidatit një kualifikim të ngushtë, që i shërben në punën e tij. Kështu kursi i Vlerësimit të pasurive të paluajtshme ka shërbyer për kualifikimin dhe licencimin e vlerësuesve të pasurive të paluajtshme. Në vazhdim të saj, kursi i “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve” shërben për kualifikimin dhe licencimin e vlerësuesve të pasurive të luajtshme, që përdoren për vlerësimin e aseteve të kompanive të ndryshme industriale dhe më tej. Kursi për “Auditim të Energjisë” shërben për kualifikimin dhe pas kalimit të një testimi bëhet e mundur licencimi i audituesve të energjisë.

Organizimi i kurseve, programet e lëndëve, materialet didaktike, orari i mësimdhënies, pranimet, etj., menaxhohen nga departamentet përgjegjëse për to, ndërsa të dhënat e kandidatëve dhe rekordet akademike të arritura mbahen dhe ruhen në sekretariatë mësimore të fakultetit përkatës. Të gjitha kurset organizohen në mënyrë të tillë që t’i përshtaten nevojave të kategorive të studentëve pjesëmarrës.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, në Departamentin e Shkencave të Tokës në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave është hapur Programi i Formimit të Vazhduar në Gjeologji, në fushat: *Mineralogji, Petrologji-Petrografi, Paleontologji (Mikro dhe Makro) dhe Gjeokimi*. Organizimi dhe hapja e këtij programi studimi është përgjigje e kërkesës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për hapje të kurseve pasuniversitare në fusha të ngushta, specifike gjeologjike

Përshtatshmëria e programeve të studimit me misionin e UPT.

Të gjitha programet e studimit që ofrohen nga UPT janë në fushat inxhinierike dhe atë të arkitekturës, në përputhje të plotë me misionin e UPT. Çdo fakultet mbulon programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në përputhje të plotë me fushat inxhinierike që mbulon sipas ekspertizës që ofron dhe misionit të fakultetit. Njësitë bazë të UPT kanë përgjegjësinë për administrimin e programeve të studimit që ofrohen në fushën inxhinierike të lidhur ngushtë me profilin akademik dhe kërkimor të



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

departamentit. Departamentet kanë ekspertizën e duhur për të menaxhuar programet e studimit që ato ofrojnë në të tre ciklet e studimit. Në mënyrë më të detajuar lista e programeve të studimit, statusi i tyre, njësitë përgjegjëse, etj., jepen në anekset e analizës mësimore të fakulteteve.

Profili kulturor dhe profesional i programeve të studimit është i lidhur me nivelin e kualifikimit që ato sigurojnë si dhe me fushën dhe nënfushën inxhinierike që mbulon.

- Programet e studimit të ciklit të parë synojnë të japin njohuri të avancuara në fushën bazë inxhinierike duke përfshirë njohuri të thelluara në fushat e matematikës, fizikës, kimisë, bazat e informatikës, gjuhë e huaj, etj., të cilat ngrihen mbi njohuritë e marra në shkollat e mesme. Mbi këto njohuri, ngrihen disiplinat që japin formimin bazë shkencor në fushën përkatëse inxhinierike, si dhe njohuri të tjera më profesionale që e aftësojnë studentin të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve inxhinierike, menaxhimin e veprimtarive ose projekteve komplekse teknike e profesionale dhe të marrë vendime në një situatë të paparashikuar punë. Në disiplinat të ndryshme aplikohen forma të kontrollit periodik gjatë zhvillimit të lëndës, për të bërë të mundur që studenti të përgatitet sistematikisht. Në mjaft disiplina aplikohen punë laboratorike, nëpërmjet të cilave studentët fitojnë aftësim praktik në fushat përkatëse. Disiplinat inxhinierike parashikojnë detyra dhe projekte të pavarura, të cilat studenti i kryen nën drejtimin e pedagogut. Gjithashtu në disiplina të ndryshme organizohen eskursione mësimore ose praktika lëndore, për të bërë të mundur njohjen e studentit me anën praktike të programit të studimit.
- Programet e studimit “Master i Shkencave” japin njohuri të thelluara shkencore në fushat inxhinierike me synimin e formimit të inxhinierëve projektues dhe drejtues të proceseve të zbatimit. Studenti aftësohet të përdorë metoda bashkëkohore llogaritëse dhe të realizojë projekte të ndryshme në fushat përkatëse inxhinierike. Programet e studimit “Master Profesional” synojnë të thellojnë shprehitë praktike inxhinierike, duke krijuar profilizime më të ngushta. Disa fakultete si: Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Fakulteti Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti Inxhinierisë së Ndërtimit kanë krijuar një diversitet programesh studimi të ciklit të dytë duke krijuar shumë profilizime. Fakultete të tjera kanë ruajtur linjën vertikale të thellimit të njohurive pa krijuar degëzime dhe profilizime të shumta. Kjo ka ardhur si rezultat i natyrës i fushës së studimit dhe kërkesave që ka tregu i punës për profilizime nga njera anë si dhe i kapaciteteve të fakulteteve për realizimin e këtyre programeve të studimit si në drejtim të kualifikimit të stafit, ashtu edhe në drejtim të infrastrukturës laboratorike dhe përvojave të fituara. Të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë të implementuara në Universitetin Politeknik janë në harmoni të plotë me fushat e kërkimit të njësive bazë dhe të ekspertizës që ofron stafi akademik. Të gjithë studentët që mbarojnë një program studimi të ciklit të parë u krijohet mundësia për të ndjekur një program studimi të ciklit të dytë në linjën vertikale ose në programe studimi të përafërta. Studentët që përfundojnë studimet në një program studimi “Master i Shkencave” në fushën përkatëse inxhinierike ka mundësi të ndjekin studimet në programet e ciklit të tretë të studimeve. Në politikat e universitetit, si dhe në zbatim të kornizës ligjore në fuqi, stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie në ciklin e dytë të studimeve është,



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

kryesisht, të paktën me grade shkencore Doktor. Në disa raste specifike, në mungesë të stafit me grade shkencore dhe tituj akademik, janë aktivizuar staf akademik me titull Msc, të cilët janë me eksperiencë në projektim dhe në zbatim. Numri i pedagogëve të angazhuar në mësimdhënie në një cikël studimi të njëjtë me kualifikimin e tij përbën rreth 10.7% e numrit total të stafit akademik të UPT, të cilët mbulojnë rreth 18.3% të ngarkesës mësimore zhvillohet në ciklin e dytë. Më poshtë jepet një tabelë me të dhëna për numrin e stafit akademik MSC të angazhuar në ciklin e dytë, ngarkesa mesatare që ata kanë kryer në ciklin e dytë si dhe përqindjet (pesha) që zë stafi akademik me Msc dhe ngarkesa e kryer prej tyre ndaj numrit të përgjithshëm dhe ngarkesën e kryer të stafit akademik, të angazhuar në Ciklin e Dytë. Në UPT, gjatë vitit akademik 2021-2022 në përbërjen e stafit akademik janë 268 me titull Msc, nga të cilët 74 prej tyre (pra 27.6%) janë angazhuar në mësimdhënie në Ciklin e Dytë.

Fakulteti	Nr. total i pedagogëve të angazhuar në ciklin e dytë	Nr. i pedagogëve me titull Msc të përfshirë në ciklin II	Mes. e orëve të realizuar në ciklin II nga të gjithë ped.	Mes. e orëve të realizuar në Ciklin e Dytë nga ped. Msc	% e numrit të ped.Msc të përfshirë në ciklin II ndaj numrit total të ped. të angazhuar në Ciklin II	% e ngarkesës së realizuar nga ped.Msc në ciklin II ndaj ngarkesës totale të realizuar në ciklin II
FGJM	50	6	117.71	125.45	12%	11.5%
FIMIF	51	4	75.2	62.25	7.8%	7.1%
FIE	25	8	141.57	112.3	28%	25.6%
FAU	61	23	92.9	79.8	37.7%	35.1%
FTI	42	6	112.6	79	14.3%	10%
FIM	52	3	130	50	5.7%	2.2%
FIN	75	24	138.14	150.1	32%	36.43%
UPT	356	74	115.4	94.12	20.78%	18.3%



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nga tabela konstatohet se fakultetet që kanë në përqindje një numër të rritur të stafit akademik me titull Msc, të angazhuar në mësimdhënie në ciklin e dytë janë FIN dhe FAU. Në nivel universiteti 20.78% e stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie në ciklin e dytë është me nivel kualifikimi Master i Shkencave.

Ngarkesa që kanë realizuar pedagogët me titull Msc në ciklin e dytë përbën rreth 18.3% të ngarkesës së përgjithshme të realizuar në këtë cikël. Duke analizuar këto shifra, pra 20.78% e stafit mësimdhënies në ciklin e dytë është me titull Msc dhe mban 18.3% të ngarkesës së përgjithshme në këtë cikël studimi,

Nëse do të krahasonim këto shifra me ato të një viti më pare do të shikonim një përmirësim të raporteve të angazhimit të personelit akademik me titull Msc në ciklin e dytë të studimeve. Të dhënat jepen në tabelën e mëposhtme:

Fakulteti		Nr. total i pedagogëve të angazhuar në ciklin e dytë	Nr. i pedagogëve me titull Msc të përfshirë në ciklin II	Mes. e orëve te realizuar në ciklin II nga të gjithë ped.	Mes. e oreve te realizuar ne Ciklin e Dyte nga ped. Msc	% e numrit te ped.Msc të përfshirë në ciklin II ndaj numrit total te ped. të angazhuar në Ciklin II	% e ngarkeses se realizuar nga ped.Msc ne cikli II ndaj ngarkeses totale të realizuar në ciklin II
FGJM	20-21	50	9	142.43	186.56	18%	23.58%
	21-22	50	6	117.71	125.45	12%	11.5%
FIMIF	20-21	55	4	134.32	55	7.3%	5.41%
	21-22	51	4	75.2	62.25	7.8%	7.1%
FIE	20-21	27	9	73.98	125.53	33.3%	31.93%
	21-22	25	8	141.57	112.3	28%	25.6%
FAU	20-21	50	19	114.79	63.74	38.00%	32.45%
	21-22	61	23	92.9	79.8	37.7%	35.1%
FTI	20-21	43	14	74.64	65.32	32.6%	18.53%
	21-22	42	6	112.6	79	14.3%	10%



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

FIM	20-21	51	4	148.44	130.75	7.84%	6.91%
	21-22	52	3	130	50	5.7%	2.2%
FIN	20-21	75	31	131.06	144.27	41.3%	44.39%
	21-22	75	24	138.14	150.1	32%	36.43%
UPT	20-21	351	90	116.93	112.77	25.64%	24.73%
	21-22	356	74	115.4	94.12	20.78%	18.3%

Në nivel institucional në ciklin e dytë janë angazhuar në mësimdhënje 17.7% më pak personel akademik me titull Msc. Edhe ngarkesa mësimore që realizon kjo kategori personeli akademik është më e ulët. Fakultetet FGJM, FIE, FTI, FIM kanë ulje të përqindjes së ngarkesës që realizojnë pedagogët pa gradë shkencore në ciklin e dytë.

Me riorganizimin e shkollave të doktoratës, për një periudhë kohore afatmesme, pritet që situatë të përmirësohet.

Programet e studimit janë të lidhura ngushtësisht me kërkesat e tregut të punës. Kompetencat në dalje të çdo programi studimi janë të mirëpërcaktuara dhe shkojnë në harmoni me mundësitë për punësim që ofrohen për programin përkatës të studimit. Në shtojcë (Tabela 2: Lidhja e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës) jepen me hollësi kompetencat në dalje dhe mundësitë e punësimit për çdo program studimi.

Organizimi i programeve të studimit dhe përmirësimi i tyre.

Të gjitha programet e studimit janë të organizuara në module, të shprehura me kredite; modulet janë të grupuara sipas kategorive formuese në raporte të mirëpërcaktuara, konform me kornizën ligjore në fuqi dhe me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. Në UPT është bërë një punë e madhe për të riorganizuar të gjitha programet e studimit në përshtatje me aktet përkatëse nën-ligjore, të cilat, për hir të së vërtetës, kanë pësuar ndryshime të herëpashershme në një periudhë kohore të shkurtër. Të gjitha programet e studimit respektojnë standardet shtetërore dhe ato institucionale në lidhje me organizimin e tyre në kredite, ndarjen e krediteve sipas aktiviteteve formuese të lëndës, përcaktimi i ngarkesës në orë në auditor për lëndën, ngarkesën javore, semestrale dhe vjetore të studentit, etj. Shpërndarja e disiplinave sipas semestrave/viteve akademike bëhet duke respektuar numrin e krediteve që duhet të fitojë studenti në një vit akademik, 60 ECTS, shpërndarja e balancuar e krediteve sipas semestrave të një viti akademik (rreth 30 ECTS), dhe formimin paraprak në njohuri dhe dije që duhet të ketë fituar studenti gjatë procesit të mësimdhënies.

Planet mësimore dhe syllabuset miratohen paraprakisht për çdo vit akademik. Plani mësimor miratohet në Senat akademik, ndërsa syllabuset në department. UPT i ka standardizuar këto dokumenta bazë, të cilat përmbajnë të gjitha elementët e nevojshëm konform me kërkesat e kornizës ligjore në fuqi. Në



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

zbatim të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies si dhe të Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë, në UPT është ngritur, në nivel njësie bazë, Këshilli i Programit të Studimit (KPS) dhe është përcaktuar koordinatori i programit të studimit, për çdo program studimi të ofruar nga departamenti, të cilët kanë për detyrë të merren me organizimin dhe menaxhimin e programeve të studimit, të ri ose ekzistues. Këshilli i Programit të Studimit është përgjegjës për hartimin e draft-propozimit të një programi të ri studimi, rishikimin dhe përmirësimin e programeve egzistuese, përgatitjen e raportit të analizës vjetore të programit të studimit dhe për mbështetjen e procesit të sigurimit të cilësisë dhe raporton në departamentin përgjegjës për të gjitha gjetjet dhe propozimet për përmirësim të programit të studimit. Kjo analizë e KPS nuk është përfshirë në raportet e fakulteteve të vitit akademik 2021-2022. Koordinatorët e programeve të studimit dhe këshillat e programeve të studimit nuk kanë filluar të funksionojnë dhe të marrin përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, Programet e studimit të ciklit të parë, të ofruara nga fakultetet e Inxhinierisë Mekanike, Inxhinierisë Elektrike dhe Teknologjisë së Informacionit, 9 programe studimi (ose 10 programe studimi me profilizime) i janë nënshtruar procesit të akreditimit. Për këto programe studimi kanë ardhur raporte finale të vlerësimit të jashtëm (përveç programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike), por ende nuk ka dalë Vendimi i Bordit të Administrimit. Vlerësimi i përgjithshëm për përmbushjen e standardeve ishte “Përmbushen Plotësisht” për programet e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Tekstile dhe Mode, Inxhinieri Elektrike, profili Automatizim i Industrisë, Inxhinieri Elektrike, profili Energjitikë, Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Informatike. Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale përmbushja tërësore e standardeve ishte “Kryesisht”.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 është punuar për hapjen e programeve të reja studimi dhe riorganizim e atyre egzistuese. Kështu Departamenti i Kimisë në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike është aplikuar për hapjen e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kimike”. Departamenti i Inxhinierisë Matematike i këtij fakulteti ka aplikuar për hapjen e programit të studimit Master i Shkencave në Aktuaristikë. Fakultetet e Inxhinierisë Mekanike dhe Teknologjisë së Informacionit kanë aplikuar për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit të ciklit të dytë “Msc në Inxhinieri Mekanike, profili energjitikë”, i cili është hapur dhe “Msc në Inteligjencë artificiale dhe optimizim”. FGJM aplikoi për rihapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Msc në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri minerare dhe Markshajderi”

Gjatë vitit 21-22 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike aplikoi për riorganizimin e programeve të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili Energjitike, në masën nën 20% si dhe në riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në Elektroenergjitikë në masën mbi 20%, duke e shdërruar në program studimi me 120 ECTS. FTI aplikoi për riorganizimin e programit të studimit MP në Inxhinieri Software, në masën mbi 20%.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

B. Organizimi i mësimdhënies

Struktura mësimore

Mësimdhënia organizohet në përputhje me strukturën mësimore të UPT. Të gjithë fakultetet i kryejnë aktivitetet e procesit mësimor në përputhje me strukturën mësimore vjetore dhe Udhëzimet përkatëse të MAS. Struktura mësimore planifikon periudhën e mësimdhënies sipas semestrave (2 semestra), sezonet e provimeve (3 sezone), sezonet e mbrojtjes së diplomave (3 sezone menjehere pas sezoneve të provimeve).

Mbështetur në strukturën mësimore, fakultetet hartojnë oraret e mësimit dhe merren masat për zhvillimin e rregullt të procesit mësimor.

Kriteret e pranimit

Pranimet në UPT zhvillohen mbështetur në kriteret që janë të përgjithshme dhe të zbatueshme për çdo kandidat, që aplikon në një program studimi, në të dy ciklet e studimit. Kriteret vendosen mbështetur në një analizë të kushteve konkrete në të cilën vepohet, duke synuar të tërhiqen kandidatët me rezultate më të larta. Për ciklin e parë të studimeve dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, kriteret propozohen nga departamenti përkatës dhe marrin miratimin përfundimtar në Senatin Akademik. Për programet e studimit të ciklit të parë, të ofruara nga fakultetet FIM, FGJM, FIN dhe FIMIF u përdor formula e përgjithshme e UPT për vlerësimin me pikë të kandidatit, në të cilën merren në konsideratë rezultati i përgjithshëm të shkollës së mesme të lartë të kandidatit si dhe rezultatet në lëndët e matematikës, fizikës dhe kimisë, sipas një peshe të përcaktuar:

$$[0.7 * \text{Mes}(\text{VKM}) + 0.3(0.5 * \text{Mes}(\text{Matematike}) + 0.4 * \text{Mes}(\text{Fizike}) + 0.1 * \text{Mes}(\text{Kimi})) * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Për programet e ciklit të parë të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe FIE u përdor një formulë e modifikuar, në të cilën nuk u mor në konsideratë rezultatet e kandidatit në lëndën e Kimisë:

$$[0.7 * \text{Mes}(\text{VKM}) + 0.3(0.6 * \text{Mes}(\text{Matematike}) + 0.4 * \text{Mes}(\text{Fizike})) * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Në programet e integruara të studimit në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, pranimi bëhet duke marrë në konsideratë rezultatin e përgjithshëm të shkollës së mesme të lartë dhe atij të testimit të organizuar nga FAU, sipas formulës:

$$0.6 * \text{Mes}(\text{VKM}) * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000 + 0.4 * T(\text{Testi}) * 100$$

Kriteret e pranimit, për ciklin e parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, miratohen 2 vite para, për t'i dhënë mundësi nxënësve të shkollës së mesme të bëjnë përzgjedhjen e disiplinave, që do të ndjekin në vitin e fundit të shkollës së mesme të lartë.

Për ciklin e dytë të studimeve, kriteret propozohen nga departamenti dhe miratohen në dekanat dhe bëhen publike në faqen zyrtare të fakulteteve dhe të UPT, si dhe shpallen në mjediset e fakultetit. Për të gjitha ciklet e studimit, vendosen kriteret minimale përjashtuese, si: nota mesatare minimale, kriteri



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

i gjuhës së huaj, etj., dhe kriteri i vlerësimit me pike, mbi bazë të së cilës bëhet renditja e aplikantëve. Kjo bën të mundur të përzgjidhen kandidatët më të mirë midis aplikantëve.

Kuotat e pranimit

Numri i pranimeve kufizohet nga kuotat e vendosura për çdo program studimi. Kuotat propozohen nga departamentet, miratohen në Dekanatin e Fakultetit, dhe në Senatin Akademik të UPT. Në propozimin e kuotave, respektohet një politikë e UPT, ku parashikohen kuota për kategoritë e veçanta të studentëve, si kandidatë nga trojet shqipfolëse jashtë kufijve, shtetas të huaj, nga shtetas në nevojë, kandidatë me aftësi të veçantë, për transferim studimesh apo program të dytë studimi. Në planifikimin e numrit të studentëve në hyrje, departamentet dhe fakultetet marrin në konsideratë kapacitetet infrastrukturore, si: ambientet e mesimdhënieve në fakultet, postet e punës në laboratore, numrin e stafit akademik efektiv dhe ngarkesën e tyre. Kuotat certifikohen nga MAS pas verifikimit të kapaciteteve pritëse që ka UPT për çdo program studimi.

Për vitin akademik 2021-2022 kuotat e pranimit për çdo program studimi janë dhënë në shtojcë (Tabela 3: Kuotat, Regjistrimet dhe Realizimet e kuotave).

Më poshtë po japim një krahasim të kuotave të miratuara për vitin akademik 2021-2022 dhe 2020-2021.

Viti akademik	Kuotat e ciklit të parë, Ba		Kuotat e ciklit të dytë Msc		Kuotat e ciklit të dytë MP	
	Gjithsej	kryesore	Gjithsej	kryesore	Gjithsej	kryesore
2021-2022	2018	1590	1350	908	748	539
2020-2021	2018	1590	1266	818	778	515

Në nivel institucional (UPT) në vitin akademik 2021-2022 janë miratuar në total 4116 kuota, nga të cilat 3037 ishin të dedikuara si kuota kryesore dhe 1079 ishin kuota dytësore. Në vitin akademik 2020-2021 kuotat totale ishin 4062, kuotat kryesore 2923 dhe ato dytësore 1138. Kuotat e propozuara për ciklin e parë të studimeve, si ato kryesore edhe ato totale nuk kanë pësuar ndryshime në dy vitet e fundit. Ka një rritje me rreth 6% të kuotave totale të ciklit të dytë Msc dhe një rënje të lehtë (rreth 3.8%) të kuotave të ciklit të dytë MP. Nga ana tjetër, në ciklin e dytë të studimeve kemi një rritje më të ndjeshme të kuotave kryesore dhe pakësim të atyre dytësore. Kjo ka ardhur si rezultat i mosrealizimit në mënyrë të vazhdueshme të kuotave dytësore.

Kapacitetet pritëse

UPT është fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes infrastrukturore dhe kushteve mjedisore si dhe në rritjen e kapaciteteve pritëse në fakultete të ndryshme. Në planet për rritjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe përmirësimin e tyre janë përfshirë edhe fakultetet FAU, FIN, FGJM.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Në shërbim të fakulteteve FAU dhe FIN ka filluar puna për ngritjen e një godine të re, që do të sigurojë një shtim të sipërfaqeve të shfrytëzueshme me rreth 7000 m². Përveç investimit në godina vëmendje i është kushtuar përmirësimit dhe rinovimit të laboratorëve në të gjitha fakultetet e UPT. Një drejtim tjetër për të rritur kapacitetet pritëse është shtimi i personelit akademik efektiv, nëpërmjet punësimeve të vazhdueshme, mbështetur në nevojat dhe propozimet e departamenteve.

Për vitin akademik 2021-2022, indikatorët mates të kapaciteteve pritëse të universitetit kanë qenë: Raporti m²/st në nivel universiteti është 7.92 dhe referuar mjediseve ku zhvillojnë aktivitetet e tyre fakultetet, raporti m²/st është si më poshtë:

- Për fakultetin e Inxhinierisë Mekanike 6.54 m²/st,
- Për fakultetin e Inxhinierisë Elektrike 9.12 m²/st,
- Për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit 11.56 m²/st,
- Për Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit 3.63 m²/st,
- Për Fakultetin e Arkitekturës & Urbanistikës 6.84 m²/st,
- Për Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave 7.67 m²/st,
- Për Fakultetin e Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike 9.16 m²/st.

Raporti ped/stud. në universitet, referuar vetem stafit akademik efektiv është 1/20.6 dhe referuar fakulteteve ky raport është:

- Për fakultetin e Inxhinierisë Mekanike 1/25.1 ped/st,
- Për fakultetin e Inxhinierisë Elektrike 1/29.1 ped/st,
- Për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit 1/13.3 ped/st,
- Për Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit 1/25.6 ped/st,
- Për Fakultetin e Arkitekturës & Urbanistikës 1/15.3 ped/st,
- Për Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave 1/13.2 ped/st,
- Për Fakultetin e Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike 1/4 ped/s.t

Ngarkesa mësimore e realizuar nga stafi akademik efektiv, për vitin akademik 2021-2022 përbën 78.3% të ngarkesës totale dhe referuar fakulteteve, gjendja është si më poshtë:

- Për fakultetin e Inxhinierisë Mekanike 92,4%
- Për fakultetin e Inxhinierisë Elektrike 90,6%
- Për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit 75%
- Për Fakultetin e Arkitekturës & Urbanistikës 46,6%
- Për Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit 84,4%
- Për Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave 89,8%
- Për Fakultetin e Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike 80,3%

Referuar këtyre vlerave të indikatorëve matës infrastrukturor të UPT dhe të fakulteteve, mund të themi se në nivel universiteti plotësohen standardet shtetërore të sipërfaqeve m²/st, pedagogëve efektiv për



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

student dhe të ngarkesës mësimore që realizohet nga PAE. Megjithatë po të analizohen shifrat sipas fakulteteve, shikojmë se:

- Në fakultetimin e Inxhinierisë së Ndërtimit, treguesi m^2 /student (është më i ulët se vlera e kërkuar nga standardet shtetërore). Kujtojmë se, për të përmirësuar situatën, në territorin ku janë godinat e FIN dhe FAU ka nisur puna për ngritjen e një godine të re me një sipërfaqe totale ndërtimi 7000 m².
- Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës ka treguesin më të ulët në lidhje me ngarkesën e mbajtur nga personeli akademik efektiv, përkatësisht 46,6%. Në këtë përqindje ndikon natyra specifike e lëndëve me karakter projektues. Kjo kërkon që fakulteti të ketë një strategji për rekrutimin e personelit akademik efektiv konform me kërkesat e standardeve të cilësisë.
- Për fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, raporti pedagog/student është i ulët, pasi ky fakultet mbulon mësimdhënien në afro 58.33% të lëndëve të vitit të parë (7-10 disiplina) në të gjitha programet e studimit Bachelor në fushat inxhinierike të UPT.

Hyrjet për vitin akademik 2021-2022

Regjistrimet për vitin e parë, në të dy ciklet e studimit bëhen sipas afateve kohore, të përcaktuar nga udhëzimet e MAS dhe kalendari i regjistrimeve të përcaktuar nga QSHA dhe RASH. Planifikimi dhe realizimi i kuotave sipas kategorizimeve jepen në tabelat e mëposhtme:

a) Shkalla e plotësimit të kuotave totale në përqindje

	UPT	FTI	FGJM	FIMIF	FIE	FAU	FIN	FIM
Cikli i parë	70.66	77.18	59	35.00	87.14	85.71	72.68	75.05
PICD	90.71	-	-	-		90.71	-	-
Msc	50.33	67.08	0	46.25	64.00	-	51.79	43.18
MP	27.9	5.74	33.17	14.12	58.49	45.71	28	17.35
Total	57.6							

b) Shkalla e plotësimit të kuotave kryesore në përqindje

	UPT	FTI	FGJM	FIMIF	FIE	FAU	FIN	FIM
Cikli i parë	90.44	101.00	70.8	45.00	100	100	100	99
PICD	102	-	-	--	-	102	-	-
Msc	76.11	89.44	0	74	77.5	-	84.89	68.95
MP	38	8	41.88	21.82	68.89	56	42.37	34
Total	77.9							



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nëse analizojmë shifrat në këtë tabelë, shikojmë që shkalla e realizimit të kuotave totale në nivel Universiteti është relativisht e ulët me rreth 57.6%, ndërsa shkalla e realizimit të kuotave kryesore është në nivelin e 77.9%. Kjo do të thotë që mosrealizime të kuotave kemi kryesisht nga kategoria e kuotave dytësore: transferim, degë e dytë, kategoritë në nevojë/të marginalizuar, trojet, etj.

Referuar programeve të studimit të ciklit të parë dhe programeve të integruara të studimeve, situata e regjistrimeve është më e mire:

- Realizimi i kuotave totale në nivel UPT në programet e studimit Bachelor është në masën 70.66% me një shtrirje nga 35% të realizuar në FIMIF deri në 87.14% të realizuar në FIE, ndërsa në programet e integruara është 90.71% në FAU.
- Realizimi i kuotave kryesore për ciklin e parë është në masën 90.44%, ku përqindja më e ulët është realizuar nga FIMIF (45%) dhe më e larta në FTI (101%), FIE, FAU, FIN (100%) dhe FIM (99%) ndërsa në programet e integruara është 102% në FAU.
- Mosrealizimi i kuotave totale në ciklin e parë, në shumicën e fakulteteve, vjen kryesisht nga kuotat dytësore (trojet, kategoritë e veçanta dhe transferimet/program i dytë studimi).

Procesi i regjistrimit të kandidatëve, në ciklin e parë të studimeve, nga kategoritë dytësore nuk shkon në linjën e regjistrimit të kandidatëve në kategorinë kryesore, dhe periudha kohore për të bërë ndryshime në shpërndarjen e kuotave dytësore në ato kryesore është shumë e limituar. Kjo bën që pavarësisht se mund të kemi vënde të lira në një program studimi dhe kërkesa nga kategoria e kandidatëve kryesorë, nuk mund të bëjmë regjistrime për shkak të pamundësisë së realizimit të rialokimit të kuotave në kohë. ***Për këtë, do të ishte mirë që fakultetet të analizojnë trendin e regjistrimeve në programet e tyre të studimit të ciklit të parë dhe të mundohen të bëjnë një planifikim sa më real në shpërndarjen e kuotave sipas kategorive.***

Një problem tjetër në mosrealizimin e kuotave në ciklin e parë evidentohen në programet e studimit të FIMIF. Departamentet e këtij fakulteti duhet të analizojnë shkaqet kryesore që cojnë në këtë mosrealizim dhe të marrin masat për përmirësim të kurrikulave duke i afruar më shumë me tregun e punës. Mos realizime të kuotave kryesore kemi edhe në programet e studimit të FGJM. Programet e studimit të FGJM janë unikale dhe me rëndësi për ekonominë në Republikën e Shqipërisë. Nevojat e tregut të punës për këto profesione mbeten të larta. Fakulteti duhet të beje nje analize ne lidhje me kete dukuri dhe te shikoj mundesitë për përmirësim. Ndoshta zyra e karrierës pranë fakultetit duhet të punojë për informimin më të gjerë të kandidatëve jo vetëm në panairët e informimit, por edhe nëpërmjet një programi informimi më gjithë përfshirës dhe shtytës. Gjithashtu forcimi i cilësisë në dalje të studentëve duhet përbëjë prioritet jo vetëm për FGJM, por edhe për fakultete të tjera.

Në programet e ciklit të dytë të studimeve, përkatësisht programet Master i Shkencave dhe Master Profesional, realizimi i kuotave janë në shkallë më të ulët se në ciklin e parë:

- Në Programet e studimit “Master i Shkencave” realizimi i kuotave totale është në masën 50.33%, ndërsa realizimi i kuotave kryesore është në masën 76.11%. Në FGJM reflektohet që



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

nuk ka patur realizime kuotash, ndërsa shifra më e lartë është në programet e studimit të FIE. Mosrealizimet vijnë kryesisht nga mosplotësimi i kuotave dytësore të alokuara për programet e studimit, por edhe si rezultat i rënjes së numrit të aplikantëve.

- Në Programet e studimit “Master Profesional”, realizimi i kuotave totale për ato profile ku ka patur regjistrime është në masën 27.9%, ndërsa realizimi i kuotave kryesore është në masën 38%. Shifrat më të ulta të realizimit të kuotave reflektohen në programet e studimit të FTI dhe FIMIF (respektivisht 5.74% dhe 14.12%), ndërsa shifra më e lartë është në programet e studimit të FIE në masën 58.49%. Mosrealizimet vijnë nga mungesa e aplikimeve për këto programe studimi. Drejtoria e Kurrikulave gjykon se ndoshta UPT duhet të hartojë strategji për të riorganizuar këto programe, qoftë në përmbajtje, duke i afruar më shumë me tendencat e tregut të punës, qoftë edhe në formën e realizimit të tyre nga me “kohë të plotë” në me “kohë të zgjatur”, meqenëse studentët janë të interesuar të kenë eksperiencë në punë.

Pavarësisht kësaj situatë të përgjithshme, ka patur raste në ndonjë program studimi të ciklit të dytë, ku kërkesat për regjistrim që vinin nga kategoritë e kuotave degë e dytë apo troje ishin më të larta se kuotat e planifikuara për këto grupe. Gjykojmë se departamentet duhet të analizojnë trendin e kërkesave që kanë pasur në vitet e fundit dhe të bëjnë një planifikim më afër gjendjes reale.

Referuar profilizimeve, për vitin akademik 2021-2022 rezultoi të mos ketë patur hyrje të reja në 6 profile Master i Shkencave dhe 11 profile Master Profesional, sipas tabelës së mëposhtme:

	UPT	FTI	FGJM	FIMIF	FIE	FAU	FIN	FIM
Cikli i parë	0	0	0	0	0	0	0	0
PICD	0	0	0	0	0	0	0	0
Msc	6	0	5	0	0	0	1	0
MP	11	1	4	1	0	0	3	2
Total	17							

Nga kjo analizë, del që njësitë bazë dhe njësitë kryesore duhet të bëjnë më shumë përpjekje për informimin e palëve të interesuara në lidhje me programet e studimit që ofrohen në ciklin e dytë, objektivat e formimit, mundësitë e punësimit si dhe kriteret e pranimit, me qëllim tërheqjen e studentëve që vijnë nga programe të ngjashme studimi të ciklit të parë ose nga institucione të tjera të Arsimit të lartë. Vëmendje t’i kushtohet organizimit të ditëve të informimit dhe përdorimit të faqes zyrtare të fakultetit si dhe të rrjeteve sociale për informim dhe marketing. Një problem tjetër që duhet të zgjidhet është edhe bërja sa më dinamike e procedurave për rishpërndarjen e kuotave të paplotësuara, me qëllim maksimizimin e hyrjeve deri në plotësimin e kapaciteteve maksimale pritëse për çdo program studimi.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

II. Informacion për ngarkesën mësimore të realizuar nga stafi akademik në v.a.2021-2022, të ndara sipas cikleve të studimit dhe parashikimi për vitin akademik 2022-2023

Ndarja e ngarkesës mësimore bëhet në departament në respektim të kërkesave të Udhëzimit 29 datë 10.09.2018 të MAS dhe përfshin:

- veprimtari në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte kursi, detyrë kursi),
- veprimtari jashtë auditorit (ndjekje dhe/ose drejtim i praktikës mësimore profesionale; konsultim studentësh, udhëheqje diplome të ciklit I, II, kontroll i dijeve (provime kolokiume).

Kjo ngarkesë realizohet nga personel akademik i departamentit, efektiv dhe jo efektiv (me kohë të pjeshme), në përputhje me planet mësimore të programeve të studimit ku është përfshirë njësi bazë përkatëse. Në disa programe studimi përfshihen në mësimdhënie edhe punonjës të Institutit IGJEUM, i cili është pjesë e UPT, duke respektuar raportet 30 % e kohës mësimdhënie dhe 70% e kohës punë kërkimore. Në ndarjen e ngarkesës mbahen në konsideratë disa kriterë:

- Norma e orëve në auditor që duhet të ketë personeli akademik në funksion të statusit të tij;
- Mbingarkesa e lejuar deri në 200 orë në auditor, sipas Udhëzimit 29, datë 10.09.2018 të MAS;
- Në raste specifike, tejkalimi deri në 100 orë në auditor të kufirit të mbingarkesës, 200 orë, për të cilën duhet të merret miratimi i Drejtuesit të njësisë kryesore;
- Ngarkesa e personelit akademik me kontratë, (pedagogë me kohë të pjeshme) shkon deri në 120 orë mësimore vjetore në auditor;
- Disiplinat ku aktivizohet pedagogu të jenë brenda fushës së tij të kualifikimit dhe te kompetencës;
- Numri i disiplinave që mbulon një pedagog, brenda mundësive të jetë brenda kërkesave të përcaktuar në Udhëzimit 29, datë 10.09.2018 të MAS;
- Të repektohet në maksimum kriteri i Ligjit 80/2015 për angazhimin në mësimdhënie të personelit akademik në një cikël studimi më të ulët se nivelit të tij të kualifikimit.

Realizimi total i ngarkesës mësimore, në auditor, në njësitë kryesore si dhe mbingarkesa maksimale për secilin fakultet jepet në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm:


Fakultetet	ngarkesa PAE (orë faktike)	ngarkesa PAE + PAK	% e ngarkesës e realizuar nga PAE	Ngarkesa maksimale e realizuar nga PAE
FGJM	14651.4	16313.3	89.8	655.4
FIM	18214.8	19703.8	92.4	495.6
FIMIF	22647.3	28197.3	80.3	451.5
FTI	11865.0	15811.0	75.0	447
FIE	9459.5	10440.3	90.6	541.5
FAU	11320.0	24274.0	46.6	524
FIN	23614.3	27964.8	84.4	947
Totale UPT	111772.2	142704.4	78.3	



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE



Në nivel institucioni, UPT plotëson standardin mbi realizimin e mbi 70% të ngarkesës nga personel akademik efektiv (PAE). Në nivel njësie kryesore, FAU rezulton me përqindjen më të ulët (46.6%) se standarti i kërkuar. Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike rezulton që PAE mban peshën më të madhe të ngarkesës e realizuar në të dy ciklet e studimit (92.4%), ndjekur më pas nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike me 90.6%.

Ngarkesa maksimale e realizuar nga një pedagog efektiv është konstatuar në FIN me 947 orë, e pasuar nga FGJM me 655.4 orë, nga FIE me 541.5 orë dhe FAU me 524 orë. Në të gjithë fakultetet, ngarkesa maksimale e realizuar tregon se kapërcehet kufiri i lejuar i mbingarkimit (200 orë).

Ngarkesa maksimale e konstatuar në FIN, prej 947 orësh, jep mesatarisht një ngarkesë ditore prej 7 orësh faktike në auditor, përgjatë të dy semestrave. Një mbingarkesë e tillë do të dëmtonte rëndë cilësinë e mësimdhënies si dhe aktivizimin e pedagogut në veprimtari shkencore apo në ndihmë të institucionit.

Në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm jepen vlerat mesatare në nivel fakulteti të ngarkesës totale të realizuar nga një PAE, mesatarja e orëve suplementare të realizuar referuar një mesatare të normës së pedagogut, orët suplementare maksimale e realizuar në fakultet, numri i pedagogëve nën normë, numri mesatar i lëndëve që mban një pedagog i fakultetit, referuar edhe numrit maksimal të lëndëve semestrale që mbahet nga një pedagog i fakultetit.




REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Fakulteti	Nr. i PAE	Mes. e ngarkesës totale të realizuar (PAE)	Mes. e oreve suplementare të realizuar	Mes. e normës së Fakultetit (ref. normes PAE)	Oret suplementare maksimale	Numri i pedagogëve nen-norme	Numri mesatar i lendeve semestrale	Numri maksimal i lendeve semestrale
FGJM	62	236.3	143.3	150	515.4	7	3	6
FIMIF	72	314.5	144.8	155	311.5	2	2.4	7
FIE	31	305.1	117	157	346.5	1	3	6
FAU	36	314.4	97.6	162	329	2	1.5	4
FTI	38	312.2	141.6	154	357	0	2.3	6
FIM	55	331.1	175.6	147	343	0	3.57	8
FIN	63	374.8	194.3	146.3	752	0	2.75	6







REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nga analiza e shifrave rezulton se vlera mesatare e ngarkesës totale në auditor, që mban një pedagog efektiv në fakultet luhartet në nivelin 236.3 orë (në FGJM) – 374.8 orë (në FIN). Mesatarja e ngarkesës së normuar në fakultet luhartet në kufijtë 147 – 162. Në secilin fakultet kemi një mbingarkesë mesatare, të realizuar nga stafi efektiv, që luhartet në kufijtë 97.4 (FAU) – 194.3 (FIN). Udhëzimi 29 përcakton një vlerë maksimale të mbingarkesës së stafit akademik efektiv prej 300 orësh në Auditor, pra në nivel fakulteti mbingarkesa mesatare e realizuar nga PAE është më e ulët se kufiri maksimal i mbingarkesës.

Numri mesatar i lëndëve që mban një pedagog në fakultete luhartet nga 1.5 (FAU) në 3.57 (FIM), ndërsa numri maksimal i lëndëve i deklaruar në pasqyrat e realizimit të ngarkesës varion nga 4 (FAU) në 8 FIM. Nga këto shifra duket se në FIM, ka pedagogë që mbajnë një numër lëndësh semestrale pothuajse 3 herë më të madhe se standardi shtetërorë (3).

Numri i pedagogëve që kanë patur një realizim ngarkese nën normë është shumë i vogël. Këto raste janë raportuar nga 4 fakultete, ku numri më i madh është në FGJM me 7 pedagogë. Në raportet e fakulteteve nuk jepen arsyet e mosrealizimit të normes mësimore nga këta pedagogë.

Për personelin akademik me kohë të pjesshme (PAK) ngarkesa e realizuar përgjithësisht është brenda normës maksimale të përcaktuar në Udhëzimin 29.

Realizimi i ngarkesës mësimore sipas departamenteve dhe fakulteteve për V.A. 2021-2022 jepen në shtojcën nr.4 dhe në shtojcën nr.5 jepet parashikimi i ngarkesës për vitin akademik 2022-2023.

III. Studentët

a) Regjistrimet e studentëve

Në vitin akademik 2021-2022, në regjistrat tanë figuronin të regjistruar në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve 15173 studentë, nga të cilët 6059 ishin studentë aktivë. Nga këto shifra konstatohet se numri i studentëve që ndjekin rregullisht studimet përbëjnë rreth 40% të numrit të përgjithshëm të regjistruar në UPT. Nëse do t'i referohemi të dhënave statistikore për vitin e parë konstatohet se numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë është më shumë se dyfishi i atyre të pranuar rishtaz. Në tabelën e mëposhtme jepen në formë të përmbledhur përqindja e studenteve që hyjnë rishtaz ndaj numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në vitin e parë, si për universitetin ashtu dhe për fakultetet. Duket se kjo përqindje është më e ulët për FGJM (me rreth 21.14%) dhe më e lartë për FIN me rreth 60.19%. Në nivel universiteti kjo shifër është afro 38.34%.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Njësiti	Nr.total i stud.e te regjistruar	Numri i student të regjistruar për herë të parë	Nr.stud.te regjistruar ne vitin e parë	% e stud. Te regjistruar per here te pare ndaj stud.te vitit te pare
UPT	15173	2396	6249	38.34
FGJM	2386	219	1036	21.14
FIMIF	793	113	383	29.50
FIE	1777	314	805	39.01
FAU	1591	168	333	50.45
FIN	2659	585	972	60.19
FTI	2101	503	908	55.40
FIM	3866	494	1812	27.26

Mund të themi se këto shifra janë tregues të kalueshmërisë në vite të studentëve të vitit të parë, e cila është mjaft e ulët. Referuar rregullores së studimeve kjo kalueshmëri është e lidhur me të gjithë ata që nuk plotësojnë kushtet për të kaluar në vitin pasardhës (d.m.th. kanë marrë më pak se 30 ECTS nga viti i parë.) Nëse do t'i referohemi shifrave të studentëve të regjistruar në vitin e parë dhe të fundit, ndaj numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar, do të kishim një situatë si në tabelën e mëposhtme:



Njësiti	Nr.total i stud.e te regjistruar	Numri i studentëve aktiv	Nr.total i stud.te regjistruar ne vitin e fundit	Nr.stud.te regjistruar ne vitin e parë	%e studentëve aktiv	% e stud.te regjistruar në vitin e fundit	% e stud.te regjistruar në vitin e parë
UPT	15173	6059	5801	6249	39.93	38.23	41.18
FGJM	2386	819	1005	1036	34.33	42.12	43.42
FIMIF	793	290	248	383	36.57	31.27	48.30
FIE	1777	903	531	805	50.82	29.88	45.30
FAU	1591	549	606	333	34.51	38.09	20.93
FIN	2659	1614	1202	972	60.70	45.20	36.56
FTI	2101	505	789	908	24.04	37.55	43.22
FIM	3866	1379	1420	1812	35.67	36.73	46.87



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE






REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Konstatohet se përqindja e studentëve të regjistruar në vitin e fundit, për të dy ciklet e studimit, në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve është 38.23% ndërsa në vitin e parë është më e lartë në 41.18. Ky raport konstatohet pothuajse në të gjitha fakultetet, me përjashtim FIN dhe FAU, ku kemi një raport të përbysur, që do të thotë, se përqindja e studentëve të regjistruar në vitin e fundit (respektivisht 45.2% dhe 38.09%) është më e madhe se ajo e studentëve të regjistruar në vitin e parë (respektivisht 36.56% dhe 20.93%). Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna që tregojnë raportet e shpërndarjes së studentëve në vitin e parë dhe të fundit për ciklin e parë të studimeve.

Njësiti	Nr. i stud. te regjistruar në ciklin e parë+PICD	Nr. i stud. të regjistruar në V.I / Ciklit I	N.r. i stud. të regjistruar në vitin e fundit te ciklit I	% e stud.te regjistruar në vitin e parë	% e stud.te regjistruar në vitin e fundit	Hyrjet në vitin e parë
UPT	12421	4922	4502	39.63	36.25	1578
FGJM	1973	892	736	45.21	37.30	152
FIMIF	654	304	196	46.48	29.97	64
FIE	1430	597	463	41.75	32.38	220
FAU (Ba+PICD)	1552	294	606	18.94	39.05	152
FIN	1940	621	881	32.01	45.41	311
FTI	1655	675	576	40.79	34.80	335
FIM	3217	1539	1044	47.84	32.45	344





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nga tabela konstatohet se, në ciklin e parë të studimeve, përqindja e studentëve të regjistruar në vitin e parë është më e lartë se ajo e regjistruar në vitin e fundit, në të gjitha fakultetet me përjashtim të FIN dhe FAU, ku ky raport është i kundërt. Kjo përqindje e lartë e studentëve në vitin e parë dhe të fundit është e lidhur me kriteret e kalimit në vitin pasardhës me kredite të mbartura nga vitet paraardhëse. Kështu numri i studentëve që kalojnë me vitin pasardhës me kredite të mbartura është pothuajse aq i madh sa edhe i atyre që mbesin në vitin e parë.

Nje dukuri tjetër, që tërheq vëmendjen, është se në ciklin e parë të studimeve, përqindja e studentëve të regjistruar në vitin e fundit (viti i diplomimit) është më e ulët se mesatarja e fakultetit për të dy ciklet e studimit. Kjo do të thotë se studentët në ciklin e parë të studimeve kanë një angazhim më të madh për të mbyllur studimet. Ndërsa në ciklin e dytë të studimeve kemi një zgjatje të periudhës së studimeve si rezultat i punësimit të studentët që në kohën e shkollimit.

Njësitë	% e stud.te regjistruar në vitin e parë, cikli I	% e stud.te regjistruar në vitin e fundit, cikli I	% e stud.te regjistruar në vitin e parë Cikli I+II	% e stud.te regjistruar në vitin e fundit Cikli I+II
UPT	39.63	36.25	41.18	38.23
FGJM	45.21	37.30	43.42	42.12
FIMIF	46.48	29.97	48.30	31.27
FIE	41.75	32.38	45.30	29.88
FAU	18.94	39.05	20.93	38.09
FIN	32.01	45.41	36.56	45.20
FTI	40.79	34.80	43.22	37.55
FIM	47.84	32.45	46.87	36.73

Përfundimi i mësipërm konstatohet edhe nëse krahasojmë shifrat e përqindjes së studentëve të regjistruar në vitin e parë për ciklin e parë të studimeve referuar atyre të dy cikleve së bashku. Kështu, për ciklin e parë të studimeve, % e studentëve të regjistruar në vitin e parë (39.63%) është më e ulët se % e studentëve e regjistruar në vitin e parë të të dy cikleve sëbashku përkatësisht (41.18%). Pra kalueshmëria në ciklin e dytë të studimeve është më e ulët se në ciklin e parë. Kjo dukuri mbetet për t'u analizuar më tej nga vetë fakultetet.

Nëse do të krahasohen regjistrimet e vitit akademik 2021-2022 referuar atij të një viti të mëparshëm 2020-2021, konstatohet një rënje e lehtë e numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar për herë të parë në UPT, me rreth 137 studentë.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Njësitë	UPT	FGJM	FIMIF	FIE	FAU	FIN	FTI	FIM
Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë v.a 2020-2021	2533	269	135	370	187	530	503	539
Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë v.a 2021-2022	2396	219	113	314	168	585	503	494

b) Diplomimi i studentëve

Referuar numrit total të studentëve, që figurojnë të regjistruar në këtë vit akademik, % e studentëve të diplomuar në nivel institucional është 12.4 %, ndërsa hyrjet në universitet në këtë vit akademik përbënin 15.8%. Përqindja më e ulët e studentëve të diplomuar rezulton në FIM dhe FAU, respektivisht 9.21% dhe 9.43%, ndërsa më e lartë rezulton në FIN (16.81%), pasuar nga FTI (15.9%) dhe FIE (14.01%). Për efekt krahasimi në tabelë jepen edhe përqindjet e të diplomuarve referuar numrit të studentëve aktiv, të cilat pasqyrojnë më realisht daljet për vitin akademik 2021-2022. Në tabelë jepet edhe një shifër tjetër që pasqyron përqindjet e daljeve referuar numrit të studentëve të regjistruar në vitin e tretë. Në këto të dhëna shikojmë se vlera më e lartë e përqindjes së të diplomuarve shkon në afro 46.89% (për FIE), ndërsa në nivel universiteti është 32.44%. Numri i madh i studentëve i regjistruar në vitin e fundit, të cilët nuk arrijnë të diplomohen është e lidhur me numrin e madh të krediteve që mbartin studentët deri në vitin e fundit dhe si rrjedhojë pamundësia e fitimit të këtyre krediteve për një periudhë kohore të caktuar. Në tabelën dhe grafikët e mëposhtëme jepen të dhëna në lidhje me diplomimin e studentëve në vitin akademik 2021-2022.



Njësitë	Nr.total i stud.e te regjistruar	Numri i studentëve aktiv	Nr.total i stud.te regjistruar ne vitin e fundit	Nr.stud. te diplomuar	% e te diplomuarve referuar nr.total të student.	% e te diplomuarve referuar nr.studenteve aktiv	% e te diplomuarve referuar studenteve të vitit te fundit
UPT	15173	6059	5801	1882	12.4	31.06	32.44
FGJM	2386	819	1005	260	10.90	31.75	25.87
FIMIF	793	290	248	86	10.84	29.66	34.68
FIE	1777	903	531	249	14.01	27.57	46.89
FAU	1591	549	606	150	9.43	27.32	24.75
FIN	2659	1614	1202	447	16.81	27.7	37.19
FTI	2101	505	789	334	15.90	66.14	42.33
FIM	3866	1379	1420	356	9.21	25.82	25.07



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE






REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE



Kjo situatë e përgjithshme lidhet edhe me faktin që në bazë të kornizës ligjore që ka qenë në fuqi, nuk ka patur afate kohore maksimale për përfundimin e studimeve. Kjo i ka fryrë regjistrat e arritjeve të studentëve me persona që faktikisht kanë shkëputur marrëdhënjet me shkollën.

c) Transferimi i studimeve/program i dytë studimi

Në Universitetin Politeknik ka politika mbështetëse dhe procedura të saksionuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënien, në lidhje me transferimin e studimeve si për studentët që i vazhdojnë studimet në një program tjetër studimi brenda ose jashtë UPT, ashtu edhe për studentët që vijnë në UPT nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Për këta të fundit, UPT ka të përcaktuar mjaft mirë kriteret e pranimit, në respekt të kuadrit ligjor, si dhe të ruajtjes së të drejtës për hyrje në programin përkatës të studimit për të gjithë kandidatët. Për vitin akademik 2021-2022, në UPT, kanë transferuar studimet në programe të tjera studimi brenda universitetit ose jashtë tij ose janë cregjistruar 366 studentë (267 nga cikli i parë dhe 99 nga cikli i dytë) dhe kanë ardhur me transferim 29 studentë. Numri më i madh i transferimeve/çregjistrimeve ndodh në ciklin e parë, ku numri më i lartë është në FGJM dhe më i vogli në FAU. Gjatë vitit akademik 2021-2022 ka patur 33 studentë të regjistruar në një program të dytë studimi, numri më i madh i të cilëve është në ciklin e dytë të studimeve.

Njësitë	Nr.stud. të cregjistruar /të transferuar	Cikli i parë	Cikli i dytë	Nr.stud të ardhur me transferim	Nr.stud. që ndjekin program të dytë stud.
FGJM	122	69	53	0	1
FIMIF	45	38	7	0	4
FIE	52	48	4	2	4




REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

FAU	18	1	17	2	1
FTI	22	21	1	14	3
FIM	62	62	0	7	20
FIN	45	28	17	4	38
UPT	366	267	99	29	71



d) Mbështetja financiare, pjesëmarrje në projekte/mobilitete

Në UPT ndiqen politika për të mbështetur financiarisht studentët të kategorive të ndryshme, duke i trajtuar me bursë studentët që vijnë nga shtresat në nevojë, ose duke i përjashtuar nga tarifa e shkollimit apo reduktuar atë, për studentët me rezultate të larta. Numri i studentëve që trajtohen me bursë është 1261 (rreth 20% e studentëve aktivë), ndërsa numri i studentëve, të cilët përjashtohen nga tarifa e shkollimit ose kanë reduktim të saj, është 1418 (23.4% e studentëve aktiv). Në UPT, numri i studentëve të shkëlqyer, (me notë mesatare mbi 9) është 830 (13.7% e studentëve aktivë), ku numri më i madh i tyre është në FTI (378). Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna në lidhje mbështetjen financiare të studentëve dhe pjesëmarrjen e tyre në mobilitete në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Për vitin akademik 2021-2022 ka patur në total 63 studentë të UPT që kanë kryer mobilitete në universitete të tjera të huaja, kryesisht në FAU




REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Njësitë	Nr.stud. me bursë	Nr.stud. që janë përjashtuar apo reduktuar tarifa e shkollimit	Nr.stud. që kanë marrë pjesë në mobilitete	Nr.stud të shkëlqyer (me notë mesatare mbi 9)
FGJM	50	83	0	6
FIMIF	44	93	0	15
FIE	121	161	0	71
FAU	205	70	45	135
FTI	407	479	4	378
FIM	140	175	14	48
FIN	294	357	0	177
UPT	1261	1418	63	830



e) Përqindja e studenteve kalues ne vit dhe përqindja e atyre qe diplomohen

Në bazë të rregullores së studimeve në UPT, studenti mund të kalojë në vitin pasardhës me kredite të mbartura. Në tabelën e mëposhtme jepen kalueshmëria në vitin pasardhës pa provime të mbartura dhe me provime të mbartura për vitin e parë dhe të dytë në ciklin e parë të studimeve, sipas fakulteteve. Mesatarja e kalueshmërisë në ciklin e parë të studimeve në UPT është 72.95%, me një diapazon nga 89.2% deri në 46.8% në FGJM. Mesatarja e studentëve që kalojnë në vitin pasardhës pa provime të mbartura është relativisht e ulët, 16.4%, me një diapazon që luhet në kufijtë nga 42.3% në FTI deri në 5.4% në FIMIF.




REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Fakulteti	Cikli i studimit	Viti	mesatarja e % e stud. që kalojnë në vitin pasardhes, pa provime të mbartura*	mesatarja e % e stud që kalojnë në vitin pasardhës**
FGJM	Bch	1	5.80	46.80
		2	9.80	89.20
FIMIF	Bch	1	13.35	53.35
		2	5.40	76.00
FTI	Bch	1	36.67	87.67
		2	42.33	78.67
FIM	Bch	1	12.00	56.25
		2	22.75	62.00
FIE	Bch	1	9.43	88.78
		2	12.90	72.17
FIN	Bch	1	12.9	81.8
		2	13.4	82.7





REPUBLIKA E SHQIPERISË




UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Në tabelën e mëposhtme jepen mesatarja e kalueshmërisë në vitin pasardhës dhe mesatarja e përqindjes së studentëve që kalojnë në vitin pasardhës pa provime të mbartura, për ciklin e dytë të studimeve, sipas fakulteteve. Nga analiza e raporteve të fakulteteve të mëposhtme, rezulton se mesatarja e kalueshmërisë në programet e studimit Master i shkencave është 69.7%, ndërsa në Master Profesional është 59.27%. Nga ana tjetër kalueshmëria e përgjithshme në programet e studimit Master i shkencave është në përqindje pothuajse të përafërt me atë të Bachelor, me një diferencë në vlerë prej 3.25%. Ndërsa mesatarja e përqindjes së studentëve që kalojnë në vitin pasardhës pa provime të mbartura, në ciklin e dytë është 57.46% Master i Shkencave dhe 50.4% për Master Profesional.

Fakulteti	Cikli i studimit	Viti	mesatarja e % e stud. që kalojnë në vitin pasardhës, pa provime të mbartura*	mesatarja e % e stud që kalojnë në vitin pasardhës**
FGJM	MP	1	31.15	82.86
FIMIF	Msc	1	58.35	97.23
	MP	1	93.75	-
FTI	Msc	1	65.67	88.33
	MP	1	9.50	20.00
FIM	Msc	1	47.80	79.20
	MP	1	34.50	74.50
FIE	Msc	1	40.00	42.50
	MP	1	43.90	59.73
FIN	Msc	1	75.5	41.1
	MP	1	89.6	-

Analiza e Studentëve Cikli II- Msc/MP (Viti 1)



■ mesatarja e % e stud. që kalojnë në vitin pasardhës, pa provime të mbartura*	31.15	58.35	93.75	65.67	9.5	47.8	34.5	75.5	89.6	40	43.9
■ mesatarja e % e stud që kalojnë në vitin pasardhës**	82.86	97.23	-	88.33	20	79.2	74.5	41.1	-	42.5	59.73



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat në lidhje me arritjet akademike të studentëve në UPT, referuar mesatares së notave në nivel fakulteti për ciklin e parë të studimeve dhe për ciklin e dytë të studimeve. Konstatohet se për ciklin e parë të studimeve, mesatarja në hyrje është më e lartë se mesatarja e diplomimit. Po kështu mesatarja e diplomimit në programet e studimit “Master i Shkencave” është më e lartë se në ato të “Master Profesional”.

Fakulteti	Cikli i studimeve	Nota mesatare e studentëve të pranuar në vitin e parë	Nota mesatare e ponderuar e studentëve të diplomuar
FGJM	Cikli I	7.54	6.00
	Cikli i dytë, Master i Shkencave	-	8.23
	Cikli i dytë Master Profesional	6.16	6.77
FIMIF	Cikli I	7.85	6.40
	Cikli i dytë, Master i Shkencave	6.78	7.71
	Cikli i dytë Master Profesional	-	7.82
FIE	Cikli I	8.11	6.12
	Cikli i dytë, Master i Shkencave	7	8.36
	Cikli i dytë Master Profesional	6.11	6.40
FAU	Cikli I	8.97	-
	Pr.It.st Master i Shkencave	9.37	-
	Cikli i dytë Master Profesional	-	-
FTI	Cikli I	9.5	7.4
	Cikli i dytë, Master i Shkencave	7.11	7.30
	Cikli i dytë Master Profesional	6.80	6.81




REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

FIM	Cikli I	7.15	6.42
	Cikli i dytë, Master i Shkencave	6.42	7.21
	Cikli i dytë Master Profesional	5.76	6.22
FIN	Cikli I	8.72	6.16
	Cikli i dytë, Master i Shkencave	6.41	7.44
	Cikli i dytë Master Profesional	5.43	6.87







REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

IV. Sigurimi i cilësisë në procesin e mësimdhënies

Fakultetet kanë bërë një analizë të detajuar për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Më poshtë jepet një përmbledhje e kësaj analize:

a. Infrastruktura ne dispozicion te mësimdhënies:

Në FGJM sallat, labororet, pajisjet audiovizive dhe IT nuk kanë patur problematikë në këtë aspekt.

FIE

Infrastruktura në mësimdhënie në fakultetin e Inxhinierisë Elektrike për vitin akademik 2021 – 2022 ka qenë në kushte shumë të mira. Pothuajse në çdo auditor janë të instaluar video projektorët dhe pajisjet audiovizive. Një problematikë e hasur gjatë vitit akademik 2021 – 2022 janë tabelat e shkrimit në salla (white board-et) dhe lapustilat e përdorur nuk janë në cilësinë e duhur.

FAU

Në vitin akademik 2021-2022 mësimi u zhvillua me dy turne nga ora 09:00 deri në orën 21:00. Kjo për arsye se një pjesë e godinës është e dëmtuar nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019. Klasat e patura në dispozicion janë 16. Laboratori i cili ka qenë aktiv është vetëm laborator i kompjuterave. Pajisjet si tavolinat inteligjente, vidjoprojektor kanë punuar në masën 80%. Për shkak të kushteve të ngushta të zhvillimit të mësimi, është pezulluar procesi për krijimin dhe blerjen e pajisjeve laboratorike.

FIMIF

DK ka një sallë laborator në të cilën, në përputhje me programet mësimore të miratuara, zhvillojnë labororet e Kimisë të Përgjithshme studentët e viteve të para të degëve: Inxhinieri Mjedisi (FIN), Inxhinieri Tekstile (në programin e vitit 2022-2023 të kësaj dege nuk përfshihet laborator), Inxhinieri Materiale (FIM); Gjeomjedisi, Gjeoinformatikë, Burime Natyrore dhe Gjeoburime (FGJM); Inxhinieri Matematike dhe Inxhinieri Fizike (FIMIF). Gjithashtu, i njeiti mjedis shërben edhe për punën kërkimore shkencore të stafit.

Është në rikonstruksion një sallë e dytë me sipërfaqe 35m² që do të shërbejë për punën kërkimore shkencore të stafit, si dhe për punimet e diplomave të studentëve të masterit shkencor e për punime doktorature. Për laboratorin e ri të kërkimit shkencor janë kryer të gjitha punimet e ndërtimit, instalimet elektrike, të ndriçimit, hidraulike, të internetit dhe të aspirim/kondicionimit, sipas standardeve më të mira. Është planifikuar paisja me dollape e tavolina pune, tavolinën ishull, si dhe kapën aspiratore sërish nga buxheti i UPT, si dhe furnizimi i një sërë pajisjesh e instrumentash, nëpërmjet një Projekti të financuar nga AKKSHI, i cili po realizohet gjatë këtij viti.

Nga ana e DK është garantuar zhvillimi i të gjitha senacave laboratorike sipas programeve përkatëse të miratuara. Megjithatë, theksojmë se salla në dispozicion, nëse respektohen standardet në këtë drejtim, ka



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

vetëm 10-12 poste pune. Pra, gjatë zhvillimit të senceve laboratorike, numri i studentëve duhet të jetë jo më shumë se 12.

Qendra e Gjuhëve të Huaja në sajë të financimit japonez nga Ambasada Japoneze në Tiranë, ka në dispozicion një laborator me të gjitha pajisjet e nevojshme për të realizuar jo vetëm mësimin e gjuhës së huaj, por edhe mund të mbulojë realizimin e aktiviteteve të tjera shkencore.

Përsa i përket sallave ku zhvillohet mësimi, ato janë të vendosura sipas orarit që secili fakultet ka.

FIM

Sa i përket infrastrukturës për realizimin e procesit mësimor FIM ka në dispozicion për të gjithë programet e saj të studimit 19 auditore mësimore. Nga këto 4 janë auditorë për leksionet me kapacitet 70-120 studentë. Duke qenë se vitin e kaluar në FIM ka patur 34 grupe mësimore, procesi mësimor është realizuar përgjatë gjithë ditës, nga ora 08.00 deri në orën 21.00 të mbrëmjes. Kryesisht programet e ciklit të dytë kanë zhvilluar mësimin pasdite. Gjithashtu për realizimin e këtij procesi janë shfrytëzuar edhe laboratorët e departamenteve. Vlen të theksojmë se auditorët në katin e dytë të shtesës anësore janë rikonstruktuar tërësisht dhe janë mobiluar në mënyrë bashkëkohore. Gjithashtu auditorët e leksioneve janë të paisura edhe me videoprojetor statik të montuar në tavanet e auditorëve. Gjithashtu në gjithë ambjentet e FIM funksionon rrjeti i wireless që mund të shfrytëzohet nga studentët dhe stafi. Laboratorët e departamenteve shfrytëzohen kryesisht për të realizuar seancat laboratorike të lëndëve përkatëse edhe për studentët e programeve të tjera jashtë FIM.

Lidhur me sallat e mesimdhënies, kjo është një ceshtje e njejte dhe e perbashket per te gjitha programet e studimit qe mbulon FIM. Mesimdhënia realizohet duke perdorur edhe pajisjet audiovizive, por kerkesa nga nje pjese e madhe e DE eshte qe te pajisjen me keto pajisje edhe sallat e tjera dhe jo vetem sallat e leksioneve. De i Energjitikes zoteron 4 laboratore. Por disa nga pajisjet nuk jane funksionale qe nga momenti kur filloi rikonstrukcioni i pjeses se FIM dhe ende nuk jane instaluar edhe pse shpenzimet per kete jane perfshire ne buxhetin e vitit 2022. Po keshtu per laboratorin e MDB kemi kerkuar te zmontohet dhe te hiqet MDB i vjeteruar moralisht dhe fizikisht dhe te behet gati ambjenti per instalimin e disa pajisjeve te reja (qe do sigurohen nepermjet nje projekti financiar nga MAS), por ende nuk eshte bere gati ambjenit megjithe kerkesen tone. Nje tjeter laborator eshte ai i fluidodinamikes, per te cilin parashikuar pajisje kompjuterike (PC), por per shkak te mosperballimit nga buxheti i vitit 2022, aktualisht nuk eshte i pajisur me kompjutera pe rte zhvilluar simulime dhe pune laboratorit te ndryshme.

Nje tjeter ceshtje eshte edhe vjeterimi i kompjuterave te nje pjese te stafit akademik dhe qe per kete vit nuk eshte mund te perballoheshin nga buxheti i parashikuar.

b. Mbulimi i disiplinave me tekste ose materiale didaktike.

Në përgjithësi mbulimi i disiplinave me tekste dhe materiale të tjera didaktike në gjuhën shqipe është në nivel të kënaqshëm. Nga raportimet e fakulteteve rezulton se programet e studimit të ciklit të parë mbulohen kryesisht me tekste. Një numër i vogël i disiplinave mbulohen nga leksione të shkruara, që i vihen në dispozicion studentit në format letër ose digjital. Në programet e studimit të ciklit të dytë, jo të



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

gjithë disiplinat mbulohen me materiale të shkruara në gjuhën shqipe. Në disa fakultete raportohet se në ciklin e dytë ka disiplina që mbulohen vetëm me literaturë në gjuhë të huaj. Në FIMIF, qendra e gjuhëve të huaja përdor literature sipas gjuhëve përkatëse. Fakultetet e tjera raportojnë që literaturën në gjuhë të huaj e rekomandojnë krahas materialeve didaktike në gjuhën shqipe, kryesisht në programet e studimit të ciklit të dytë, por jo vetëm. Më poshtë jepen në formë të përmbledhur raportimet e fakulteteve.

FGJM

Në programet e studimit të ciklit të parë, shumica e lëndëve mbulohen me tekste në gjuhën shqipe, por ato janë, përgjithësisht, tekste të vjetra, ndërsa në programet e studimit të ciklit të dytë mbulimi me tekste në gjuhën shqipe është më i ulët. Lëndët të cilat nuk mbulohen me tekste, në gjuhën shqipe, si në programet e studimit të ciklit të parë, ashtu edhe në ato të ciklit të dytë, mbulohen me materiale të shkruara, në formë cikël leksionesh, që i vihen në dispozicion studentëve, në Hard Copy dhe/ose në format elektronik. Në FGJM nuk mbulohet asnjë disiplinë vetëm me materiale në gjuhë të huaj.

FIM

Departamenti i Energjitikës mbulon me tekste 13 disiplina në ciklin e parë të studimeve dhe 19 disiplina në ciklin e dytë të studimeve. Me leksione të shkruara mbulohen 11 disiplina në ciklin e dytë të studimeve. *Departamenti i Mekanikës* 18 module mbulohen me tekste në gjuhën shqipe, 22 module me leksione të shkruara në gjuhën shqipe, 10 module shoqërohen me rekomandime për përdorim me tekste e gjuhë angleze/italiane, 12 module ne bch mbulohen me tekste dhe 6 module ne msc/mp mbulohen me tekste. *Departamenti i Prodhim-Menaxhimit* mbulon të gjitha disiplinat me tekste ose leksione të shkruara në gjuhën shqipe.

FIE

Rreth 80 % e disiplinave që zhvillohen në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike janë pothuajse të mbuluara me tekste mësimore në gjuhën shqip të ndara sipas cikleve të studimit. Rreth 10 – 15 % e disiplinave të mbuluara me materiale të shkruara në gjuhën shqip, të ndara sipas cikleve të studimit. Një disiplinë është e mbuluar vetëm me material në gjuhë të huaj.

FIN

Përsa i takon mbulimit me literature, mund të thuhet se të gjitha disiplinat të cilat mbulohen nga Departamentet ne FIN, pothuaj janë të plotësuar me ciklin e plotë të leksioneve dhe seminareve këto, të përgatitura nga titullarët e lëndëve , në bazë të programit mësimor të sejcilës lëndë.

FAU

Në departamentin e Arkitekturës, të gjitha lëndet janë të mbuluara me materiale të shkruara në gjuhën shqipe. Në trajtën e librit apo të dispensave të pabotuara zhvillohen rreth 8 disiplina në të dy programet e studimit. Te gjitha grup-lendet, si ato projektuale, si ato teorike apo grafike kane bazën e leksioneve dhe



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

materialeve didaktike te përgatitura ne gjuhen shqipe. Titujt janë te referuar ne silabuset e lendeve te programeve te studimit.

Në Departamentin e Urbanistikës të gjitha lëndët disponojnë materiale në gjuhën shqipe, në trajtën e librit apo të dispensave të pabotuara.

Në departamentin e Restaurimit dhe teknologjisë së Arkitekturës janë mbuluar me materiale didaktike në gjuhën shqipe, në trajtën e librit 5 disiplina në Master Shkencor në Arkitekturë – Profili Arkitekt/Profili Urbanist, 1 disiplinë në Master Shkencor në Arkitekturë – Profili Arkitekt dhe 3 disiplina në Programin e Studimit Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn. Në Departamentin e Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës mbulohen me materiale didaktike në formën e leksioneve të shkruara në gjuhën shqipe, 10 disiplina në Master Profesional në Restaurimin e Monumenteve të Kulturës, 3 disiplina në Master Shkencor në Arkitekturë – Profili Arkitekt/Profili Urbanist dhe 3 disiplinë në Programin e Studimit Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn.

FIMIF

Të gjitha disipinat e nivelit bachelor janë mbuluar me tekste në gjuhën shqipe. Në total janë 3 tekste bazë : Kimia e Përgjithshme për studentët e degëve Inxhinierike, me autor R.Lilo, E.Baraj, V. Hoxha, A.Jano, Kimia organike me autor E. Tako, I.Gjikaj dhe Kimia Fizike me autor B.Dida.

Ndërkohë në disa degë, pedagogët përkatës kanë rekomanduar edhe tekstet: Kimia – Shembuj dhe problema me autorë E. Noçka, B. Dida, D. Karaj, si dhe Kimia – Problema te zgjidhura, me autorë D. Karaj, B. Dida, E. Noçka.

Të gjitha disipinat janë mbuluar me materiale plotësuese në formën e prezantimeve në ppt, apo si leksione të regjistruara.

c. Rezultatet e monitorimit të mësimdhënies (kontrollet e departamentit, të dekanatit dhe sondazhet e studentëve).

FGJM

Monitorimi është kryer periodik dhe i ndarë në tre përgjegjës për monitorimin, Departamenti, Sekretaria mësimore dhe zv. Deakni për mësimin. Nga këto monitorime nuk është vërejtur ndonjë problematikë e theksuar në mësimdhënie.

FIE

- Procesi mësimor per lendet qe mbulon DSEF, DE & DA, është realizuar sipas planeve mësimore përkatëse për ciklin e Bachelor dhe per ciklin Master Shkencor dhe Master Profesional. Ngarkesa mësimore për pedagogët është ndarë para fillimit të procesit mësimor, ku secilit pedagog i është përcaktuar ngarkesa mësimore dhe ky parashikim i bere ne fillim te vitit ka rezultuar se nuk ka patur perputhshmeri te plote me ngarkesen e realizuar ne fund te vitit akademik.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

- Për diplomat Master është treguar kujdes që lëndët të mbulohen kryesisht nga pedagogë me tituj dhe grada ose që vijnë me eksperience nga prodhimi, me qëllim orientimin e studentëve në fushat kërkimore në të cilat punohet sot, si dhe për të krijuar mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave edhe midis pedagogëve.
- Ngarkesa mësimore në mësimdhënie është mbi normë. Në menyre sasiore në tabelat e mesiperme janë dhënë ngarkesat perkatese, si dhe ngarkesat e plota për çdo anetar departamenteve (DSEF, DA & DE).
- Anetaret e Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë dhe të Automatikës janë angazhuar në veprimtari mbështetëse, për mbështetjen dhe përgatitjen e procesit të mësimdhënies dhe për institucionin.

FIMIF

- Procesi mësimor është zhvilluar me korrektesë dhe shumë përgjegjshmëri nga ana e stafit të FIMIF. Programi mësimor është përmbushur plotësisht. Në përgjithësi, gjatë zhvillimit të leksioneve janë përdorur edhe prezantimet në powerpoint, si dhe është synuar aktivizimi i studentëve, duke patur parasysh që ata vinin nga një periudhë afro 2-vjeçare post-COVID. Për të rritur efikasitetin e përvetësimit të dijeve prej studentëve dhe për t'i nxitur ata për një punë sistematike dhe të pavarur, në seminare i është kushtuar rëndësi kontrollit frontal paraprak të njohurive teorike të studentëve, caktimit dhe kontrollit të detyrave të shtëpisë duke vënë theksin në zgjidhjen drejt e saktë të ushtrimeve e problemave.
- Pavarësisht përpjekjeve për të përfshirë në mënyrë aktive studentët në leksione e seminare, për një pjesë të tyre kishte shumë mangësi të formimit nga shkolla e mesme. Nga ana tjetër, ulja para disa vitesh e numrit të krediteve të lëndës së kimisë së përgjithshme për disa degë dhe zhvillimi i seminareve me 1 ose 1,5 kredite, ka ndikuar negativisht dhe ka rritur jo vetëm ngarkesën e pedagogut gjatë orës së mësimi, por edhe të studentëve. 1-1.5 kredite për seminarët është e pamjaftueshme për të kryer si duhet kontrollin e njohurive të studentëve, sqarimin e paqartësive dhe pyetjeve që kanë lindur nga studimi i teorisë. Kjo bëhet edhe më e vështirë, duke patur parasysh formimin gjithnjë e më të cunguar të studentëve nga shkolla e mesme.
- Një problem shqetësues që ende nuk ka marrë zgjidhje, është çështja e zhvillimit të seancave laboratorike për ato degë që e kanë zhvillimin e laboratoreve pjesë të kurrikulave të tyre, në grupe me jo më pak se 20 studentë. Departamenti i Kimisë, e ka rishqyrtuar këtë çështje në mbledhjen e tij të datës 15.10.2021 dhe Vendimin nr. 9 të kësaj date, së bashku me argumentet mbështetëse, e ka përcjellë në Dekanatin e FIMIF. Megjithatë ky problem mbetet ende i pazgjidhur. Theksojmë edhe njëherë se çështja e zhvillimit të laboratoreve në lëndën e kimisë, nuk duhet të trajtohet thjesht si çështje numrash. Ajo lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me thelbin e lëndës dhe përmbushjen e programit për aftësimin e studentëve në zbatimin praktik të njohurive teorike, por gjithashtu edhe me zbatimin e Rregullave të Sigurimit të Jetës dhe Shëndetit të stafit dhe të studentëve. Duke patur parasysh që edhe vetë VKM përcakton numrin maksimal të studentëve të pranishëm, jo numrin minimal të tyre, si dhe duke synuar të përmbushen standardet në procesin e mësimdhënies (laboratori



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

i DK garanton punën me standarde për 8-10 studentë), ne sërish kërkojmë që kjo çështje të rishikohet dhe të zgjidhet konform kërkesave të paraqitura.

FIM

Vlen të theksohet se vitin e kaluar u realizua ne fund te semestrave sondazhi me studentet per cdo lende dhe program studimi. Ne baze te sondazheve te semestrit te pare, rezultatet ishin mjaft te kenaqshme dhe pozitive per stafin e departamenteve. Me teper mund te behet ne drejtim te sugjerimit te literatures baze dhe prezantimit te programit te lendeve nga i gjithe stafi per studentet.

FIN

Gjatë vitit akademik 2021-2022, nga kontrollat periodike të zhvilluara nga Drejtuesit e Departamenteve dhe nga takimet e zhvilluara me studentët, nuk u konstatua ndonjë problematikë në lidhje me zhvillimin e mësimin.

- d. Realizimi i praktikave mësimore: Kontratat e lidhura, kompanitë ku kryhen praktikat, mbikqyrja e praktikave, kontrolli përfundimtar i studentëve për praktikat.**

FGJM

Praktikat mësimore janë kryer në përputhje me planet mësimore. Administratori, Dekani dhe Zv. Dekani i FGJM bënë një tur në të gjithë destinacionet e praktikave mësimore duke vendosur kontakte me njësitë e prodhimit dhe industrisë ku studentët kryejnë praktikat si dhe me njësitë akomoduese, për të lidhur marrëveshjet në lidhje me akomodimin dhe trajtimin e studentëve gjatë praktikave mësimore në terren.

FAU

Praktika profesionale, lëndë e vitit 4 të studimit në arkitekturë e urbanistikë u bë në studio profesionale arkitekturë, ose ndjekja e praktikës mësimore në atelie modelimi me fokus rilevimin arkitektonik (grupet e dizajnit). Një pjesë e studentëve kryen praktikën në Bashkinë e Tiranës, një pjesë në IKTK, një pjesë në Megatek dhe një grup i vogël në fondacionin CHwB.

FIN

Realizimi i praktikave mësimore janë zhvilluar sipas proceduarave standarte dhe studentët kane qënë të monitoruara nga komisionet e ngritura me vendim të Departamenteve.

FIE

Kujdes është treguar me studentët e vitit të trete të cilët duhet të kryejnë praktikat pranë kompanive private apo institucioneve shtetërore, me qëllim plotësimin e krediteve të praktikës. Dokumentacioni i plote i praktikave mesimore, si kontratat e lidhura, prezantimet e kryera ndodhet i diponueshem ne Departamentet. Në fund të materialit në tabelë janë dhënë kompanitë në të cilën FIE ka marrveshje për kryerjen e praktikave mësimore. Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë realizuar mbrojtjet e praktikave dhe diplomave sipas sesioneve të shpalluara nga institucioni.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

FIM

Praktikat mësimore për V.A. 2021-2022 u zhvilluan në kompani nga pedagogët e caktuar në Departament. Per zhvillimin e praktikave mesimore ne ciklin e pare dhe te dyte Departamenti i Energjitikes eshte bazuar tek marreveshjet e bashkepunimit qe ka lidhur UPT me subjekte te ndryshme, me qëllim përgatitjen praktike të studentëve praktikant për përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit nga ana e tyre, në përputhje të plotë me programin e praktikës. Bazuar pjeserisht ne keto marreveshje, jane lidhur kontratat per kryerjen e praktikës mesimore me perfaqesues FIM, me subjekte te ndryshme perfaqesuar nga administratori i tyre, bazuar tek Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Praktikat mesimore jane zhvilluar ne baze te programit te praktikës mesimore, te hartuar nga Departamenti per secillin program studimi, si dhe te nje rregullore per ruajtjen e dhendetit dhe sigurimin teknik te studenteve gjate zhvillimit te praktikës. Keto dokumenta ju jane vene ne dispozicion studenteve para fillimit te praktikës. Cdo student dorezon te gjitha detyrimet ne perputhje me programin e zhvillimit te praktikës. Gjetja e kompanive për realizimin e praktikave mbetet një problem pasi pranojnë studentë në numër të reduktuar.

Eshte synuar te disiplinohet organizimi i praktikave mesimore me ente shterore te specialitetit apo ente private te specializuara ne drejtim (kontrate me DPRTSH).

Puna e stafit te departamentit ne drejtim te realizim te praktikave eshte mjaft e mire, me nje perkushtim te larte studentet ndahen dhe vendosen ne kompani prodhuese ne qytete te ndryshme duke u nisur si prioritet nga preferencat e studenteve fillimisht. Me pas stafi perdor databazen e kompanive qe departamenti ka ne dispozicion me numra kontakti dhe personat pergjegjes nga kompanite, pasi konfirmohet gatishmeria e kompanive per te pritur studentet, pergatitet plani dhe programi i punes per periudhen e zhvillimit te praktikës, pergatitet kontrata ne tre kopje dhe studentet monitorohen ne menyre te vazhdueshme nga pedagoget pergjegjes me vizita ne kompani, telefonata me stafin pergjegjes ne kompani si dhe me studentet, duke adresuar cdo problematike te mundshme. Ne fund studentet paraqesin raportin per punen dhe aktivitetin e kryer gjate periudhes ne kompani.

- e. Realizimi i detyrimeve (projekte/detyra/laboratorë): realizimi i detyrimeve, konsultimet, dorëzimet.**

FIMIF

Nga të gjithë anëtarët e stafit të DK është bërë kontrolli i rregullt i frekuentimit të seminareve prej studentëve. Kanë fituar të drejtën e paraqitjes në provim vetëm ata studentë që kanë kryer dorëzimin dhe mbrojtjen e të gjitha punëve të laboratorit, sipas programeve përkatëse, si dhe kanë përmbushur 75% të pjesëmarrjes në seminare.

Nga disa pedagogë realizohen teste kontrolli në fillim të vitit, ndërkohë që pothuajse në të gjitha disiplinat janë realizuar kontrollet e ndërmjetme (në formë detyre me shkrim apo kolokiumi) dhe ato përfundimtare,



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

në përputhje të plotë me programet dhe zhvillimin e lëndës. Duke parë rezultatet relativisht të ulëta të një pjese të konsiderueshme të studentëve në këto kontrolle, por edhe gjatë zhvillimit të seminareve, janë zhvilluar edhe konsultime përpara provimeve, për të cilat janë njoftuar studentët e atij viti akademik, por edhe studentë të tjerë që i kanë lëndët e kimisë të mbartura ndër vite.

FIN

Konsultimet dhe dorëzimi i detyrimeve përkatëse të cdo lënde janë bërë me pjesmarjen në auditor, sipas urdheresave dhe udhëzimeve të ardhura nga institucionet.

FIE

Realizimi i detyrimeve, konsultimeve si dhe dorëzimet e laboratorëve apo projekteve të kursit për vitin akademik 2021 – 2022 janë realizuar konform rregullores së mësimore të UPT. Problematikat që dalin në lidhje me laboratorët të Departamenti të Elektroteknikës janë baza materiale e vjetëruar.

FIM

Keto elemente të mesimdhënis janë realizuar 100 % në Departamentin e Energjitikës edhe në kushtet online dhe mundësia për disa në auditore. Nuk ka pasur problematika.

Detyrimet për V.A 2021-2022 u realizuan në periudhat e caktuara në strukturën akademike nga Rektorati i UPT. Nuk kishte problematika.

Është akumuluar eksperience për denien e kontrollin e detyrave të projekteve me sistemi online dhe kapëcimin e vështirësive të procesit në këto veksperience të pare e cila po shkon drejt përmirësimit të hallkave të tij.

Te gjitha detyrimet janë realizuar në mënyrë korrekte, përfshirë detyra kurse, projekte kurse me mbrojtje dhe vlerësim me note, praktikant dhe punët e laboratorëve shoqëruar me relacione përkatëse. Te gjitha detyrimet arshovohen pranë departamentit.

f. Vlerësimi i studentëve: organizimi i sezoneve të provimeve, format e marrjes në provim dhe ato të vlerësimit.

FIE

Në organizimin e provimeve në FIE është treguar kujdes i veçantë. Para përfundimit të semestrit të parë dhe të dytë është bërë caktimi i datave të provimit me pedagogët si dhe janë përcaktuar komisionet e provimeve për çdo lëndë. Forma e vlerësimit të studentëve në varësi të lëndëve është provim me shkrim në masën 100%, provim me shkrim dhe në teori.

FIN

Organizimi i provimeve është bërë në auditor, sipas rregullores të Institucionit dhe Programeve të studimit. Gjatë sezoneve të provimeve nuk janë konstatuar problematika.

FIMIF

Provimet janë realizuar fillimisht me shkrim, me fletore të sekretuara dhe studentët që kishin arritur kufirin e nevojshëm të pikëve në provimin me shkrim ju nënshtruan dhe pyetjes me gojë. Secilit prej studentëve ju është vënë në dispozicion provimi i korrigjuar, në mënyrë që të sqaroheshin për paqartësitë apo kontestimet që mund të kishin në lidhje me vlerësimin e kryer. Gjatë zhvillimit të



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

provimeve, vazhdon të mbetet problem tendenca e studentëve për të kopjuar, në veçanti, duke përdorur mjetet e komunikimit elektronik. Mendojmë se zgjidhje për këtë do të ishte vendosja e përdorimi i bllokuesit të valëve në të gjitha mjediset e UPT-së ku zhvillohen provimet. Në këtë mënyrë, edhe studentët do të ndërgjegjësohen për domosdoshmërinë e studimit gjatë gjithë zhvillimit të lëndëve dhe do të përgatiten seriozisht për rezultatet përfundimtare.

FIM

Duhet të theksojmë se FIM ka të miratuar një procedurë të veçantë për kontrollin e dijeve, ku përfshihen të gjitha format e kontrollit si: provime, detyrime vjetore, kolektive, etj. Vitin e kaluar për formalizimin e vlerësimeve është aplikuar platforma e re e Sekretarisë Mesimore PITAGORA e ofruar nga RASH.

Provimet janë realizuar konform strukturës mesimore, në auditore dhe plotësisht në përputhje sipas metodës së përcaktuar në programin e cdo lende dhe udhëzimit përkatës për zhvillimin e tyre. Nuk ka pasur problematike për ndonjë nga provimet.

Problematike mendojmë se paraqet adoptimi i stafit me platformën e re si dhe rregullimi i problematikave të shfaqura nga platforma gjatë implementimit.

g. Procesi i diplomimit: cilësia e përgatitjes së punimit, kontrollet, mbrojtja.

FIE

Për diplomën është zbatuar rregullorja për regjistrimin e temave të Diplomave, realizimin e kontrolleve paraprake dhe me pas miratimin e tyre nga departamenti - Udhëheqësit e diplomave kanë qenë pedagogët efektiv, të cilët kanë pasur nën udhëheqje mesatarisht nga 5-6 studentë. Për mbrojtjen e praktikave dhe diplomave është bërë ngritja dhe miratimi i komisioneve përkatëse dhe procesi i mbrojtjes është realizuar në datat e përcaktuara dhe konform rregullores.

FIN

Temat e diplomave për të dy ciklet e studimit, kanë qënë në nivel të kënaqshëm dhe mbrojtjet e tyre janë bërë në auditor.

FIM

Edhe për këtë proces të rëndësishëm në FIM është miratuar dhe zbatohet një procedurë e veçantë për diplomimin në të dy ciklet e studimit.

Verehet një cilësi e mirë dhe përgjithsisht mesatare në përgatitjen e punimeve të diplomave, me gjithë angazhimin e studentëve për t'i realizuar; kontrollet kryhen rregullisht me qëllim përmirësues në punimit. Nuk ka pasur problematika.

Për V.A. 2021-2022 sipas udhëzimeve të Procedurave P06 dhe P08 të FIM u morën masat në Departament për caktimin dhe shpalljen e temave të diplomave për të dy ciklet për studentët online. Studentët u njoftuan dhe në periudhat e caktuara erdhën dhe vazhduan punën për kryerjen e diplomave.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Në Departament u caktuan gjashtë pedagogë për rregjistrimin e temave dhe kontrollin e temave të diplomave. Ky proces nuk pati problematika.

Problematika të vogla me se shumti lidhur me provimet e mbartura dhe kohën e paket në dispozicion që i mbetet studentit për realizimin e temës së diplomës; si dhe problematika e pagesave të pashlyera nga studentet.

Një përmirësim i të gjitha hallkave të proshit të diplomimit prej dhenies së tematikës së diplomës kontrolleve të realizimit deri tek mbrojtja e temës së diplomës është i nevojshëm të realizohet.

IV. PROBLEMATIKA TË PËRGJITHSHME

- i. Një vlerësim të përgjithshëm të komunikimit me strukturat e njësisë kryesore dhe të institucionit, duke vënë theksin mbi përmirësimet e mundshme në këtë komunikim;**

FIE

Bashkëpunimi ndërmjet departamenteve si dhe departamenteve me Dekanatin e FIE ka qenë i duhur. Çdo problematikë e hasur gjatë vitit akademik 2021 – 2022 është trajtuar bazuar në rregulloret dhe kornizën ligjore në fuqi duke dhënë zgjidhjen e duhur.

- ✓ Një problematikë është paraqitur në lidhje me rekrutimin të stafit të ri në Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë ku nisur nga refuzimi nga Rektorati për hapjen e konkursit të dy staf efektiv për realizimin e ngarkesës tashmë do të jete e nevojshme parashikimi i 6 pedagogëve të ftuar dhe pesha e tyre kalon nga **11%** në **24%** e cila ndikon në cilësinë e mësimdhënies.
- ✓ Duhet informacione më të detajuara në lidhje me rezultatet e sondazheve të studentëve në vijë të përgjithshme se çfarë mund të përmirësohet në nivel departamenti dhe modul lende me specifikisht problematikën që kanë dalë në mënyrë që të merren masa në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mësimdhënies.

FAU

Standardizimi i procedurave/formateve mbetet një nga elementet mbi të cilin duhet reflektuar. Është me rëndësi unifikimi i konvertimit në ore pune të zërave të udhëzimit nr. 29 i MAS, sidomos për aktivitetet jashtë auditorit, konvertimit dhe vlerësimit të kontributit institucional dhe profesional të PAK.

Decentralizimi i vendimmarrjes. Departamentet si njësi baze nuk kanë nën varësi asnjë strukturë përmes të cilës mund të kryejnë procese të cilat ligji i arsimit të lartë ua dikton.

Departamentet nuk kanë instrumente procedurale për të gjeneruar të ardhura nga shërbimet për të tretet dhe për të menaxhuar ato. (nuk hyjnë dot në marrëdhënie kontraktuale me pale të treta, nuk kanë administratë për të menaxhuar aktivitetin financiar)

Decentralizimi i ekzekutimit të buxheteve në nivel njësie baze.

FIN



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Përsa i takon komunikimit të Departamentin me njësisë kryesore nuk ka pasur ndonjë problematikë. Kjo gjë është reflektuar dhe me kalimin me sukses të këtij viti të vështirë.

FIMIF

- Brenda te njetit fakultet per lende te njejta ne programe te ndryshme studimi eshte vene re numer i ndryshem kreditesh dhe kategorish. Megjithese programet e lendeve te DIM ne vitet e para përshtaten me formimin e studenteve per vitin akademik 2021-2022, vihen re disa mangesi te pergjithshme ne formimin paraprak akademik matematik nga shkolla e mesme te studenteve te viteve te para. Permiresimi qe sugjerojme lidhet me njohurite e marra ne shkollen e mesme te cilat jane thjeshtuar mjaft dy vitet e fundit akademike dhe te cilat ndoshta duhen ripare. Të shihet mundësia e organizimit nga ana e Fakulteteve të UPT-së të kurseve përgatitore për studentët në lëndën e Analizes matematike dhe Algjeber dhe Gjeometri.
- Problem mbetet rritja e investimeve në drejtim të laboratoreve, mësimore dhe kërkimore shkencore.
- Ndonëse programet e Lëndëve të Kimisë së Përgjithshme dhe të Kimisë Organike janë në përshtatje dhe vazhdim logjik të programeve të shkollës të mesme, vihet re se studentët vijnë me njohuri mjaft të cinguar nga shkolla e mesme dhe shpesh nuk njohin as konceptet bazë të kimisë. Kjo lidhet me faktin se zhvillimi i kimisë si lëndë e detyrueshme vetëm në dy vitet e para të shkollës së mesme, për më tepër me një ngarkesë mjaft të ulët (vetëm dy orë në javë) është i pamjaftueshëm për për t'ju dhënë nxënësve formimin e duhur bazë në kimi. Ndërkohë, në vitin e tretë të shkollës së mesme kimia është lëndë me zgjedhje dhe të dhënat flasin se vetëm një numër i vogël i nxënësve e zgjedhin atë.
- Po kështu zhvillimi i lëndës (gjithmonë gjatë cikleve parauniversitare) vetëm në aspektin teorik, pa e shoqëruar atë me punë praktike laboratorike për shkak të mungesës së laboratorëve, është një faktor tjetër i rëndësishëm që përcakton dijet jo të plota dhe të qëndrueshme të nxënësve dhe shpjegon vështirësitë që ata hasin për arritjen e rezultateve të duhura në këtë lëndë.
- Formimi i cinguar i studentëve në lëndët shkencore, në përgjithësi, si dhe në atë të kimisë në veçanti, përbën një problem të madh, si për pedagogun ashtu dhe për studentët. Kjo pasqyrohet dhe në rezultatet e pakënaqshme në kalueshmëri dhe në mesatare. Në këto kushte do të sugjerohet që:
 - zgjedhja e lëndës së kimisë në vitin e tretë të shkollës së mesme, të bëhet kusht paraprak për pranimin e studentëve në degët inxhinierike.
 - të shihet mundësia e organizimit nga ana e Fakulteteve të UPT-së të kurseve përgatitore për studentët në lëndën e kimisë, por edhe në lëndët e tjera shkencore (fizikë, matematikë) para fillimit të vitit akademik.
 - të shihet mundësia e rritjes së krediteve (në veçati për seminarët, nga 1 apo 1.5 në 2 kredite) për zhvillimin e lëndës së Kimisë së Përgjithshme
 - të shqyrtohet domosdoshmëria e kryerjes së laboratoreve, qoftë edhe me 0,5 kredite, nga të gjitha degët e UPT-së që zhvillojnë lëndën e kimisë, ku puna në laboratore të jetë e organizuar



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

në grupe me 8-10 studentë, në mënyrë që të ketë efikasitet dhe që secili prej tyre të angazhohet drejtpëdrejt me zhvillimin e detyrave praktike.

FIM

Komunikimi është korrekt dhe bashkepunues për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë aktiviteteve të ndryshme. Sekretaria mesimore ka qenë në lartësi të duhur për të dhënë zgjidhje çdo problem nga ana e studenteve për të mos penguar procesin e regjistrimit në provime dhe në diplomim po ashtu.

- ii. vlerësime dhe rekomandime për ndryshime të sistemit apo akteve ligjore e nënligjore në fuqi që ndikojnë në veprimtarinë e IAL-se, të shoqëruar me arsyetime të hollësishme;**

FIM

Përsa i përket akteve rregullative gjatë v.a. 2021-2022 në FIM është vijuar me miratimin e një sere procedurash të ndryshme lidhur me procesin mësimor. Janë rinovuar gjithashtu rregulloret e programeve të studimit bachelor duke qenë se kaluan në procesin e akreditimit të tyre. Keto akte kanë shërbyer për një përmirësim të ndjeshëm të funksionimit të fakultetit dhe kanë bërë të mundur harmonizimin e punës ndërmjet hallkave të ndryshme si dhe kanë përcaktuar qartë detyrat e secilit në këto procese të rëndësishme të mesimdhënisë.

- iii. Vlerësime dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe një përshkrim të ndërveprimit të IAL-së me strukturat e varësisë të ministrisë.**

FIM

Ndryshimet e shpeshta të urdherave dhe udhëzimeve të MAS kanë krijuar konfuzion dhe paqartësi tek stafi akademik lidhur me procesin e mesimit, si: ngarkesa mesimore, elementet e programit të studimit, dokumentat baze, etj.